

**SiCRED sh.a.**

*Pasqyrat Financiare të Vecanta*

*për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013*

*(Me raportin e auditorit të pavarur bashkëlidhur)*

**PËRMBAJTJA**

	<b>Faqe</b>
<b>RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR</b>	
<b>PASQYRAT FINANCIARE TË VECANTA</b>	
<b>PASQYRA TË VECANTA TË POZICIONIT FINANCIAR</b>	<b>1</b>
<b>PASQYRA E FITIM OSE HUMBJEVE DHE E TË ARDHURAVE     TË TJERA PËRMBLEDHËSE</b>	<b>2</b>
<b>PASQYRA TË VECANTA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL</b>	<b>3</b>
<b>PASQYRA TË VECANTA E FLUKSIT TË PARASË</b>	<b>5</b>
<b>SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE TË VECANTA</b>	<b>6-35</b>
<b>SKEDULE SUPLEMENTARE</b>	<b>i-ii</b>



**KPMG Albania Sh.p.k**  
"Dëshmorët e Kombit" Blvd  
Twin Towers Buildings  
Building 1, 13th floor  
Tirana, Albania

Telephone +355(4)2274 524  
+355(4)2274 534  
Telefax +355(4)2235 534  
E-mail al-office@kpmg.com  
Internet www.kpmg.al

## Raport i Audituesit të Pavarur

Aksionerëve të  
Sicred Sh.a.

Tiranë, 20 Qershor 2014

Ne kemi audituar pasqyrat e veçanta financiare bashkëlidhur të Sicred Sh.a. ("Shoqëria"), të cilat përbëhen nga pasqyra e veçantë e pozicionit financiar në datë 31 dhjetor 2013 si edhe pasqyra e veçantë e fitim humbje dhe të ardhurave përmbledhëse të tjera, pasqyra e veçantë e ndryshimeve të kapitalit dhe pasqyra e veçantë e flukseve monetare për vitin e mbyllur në atë datë, si dhe një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël dhe shënimeve të tjera sqaruese.

### *Përgjegjësia e Drejtimit për Pasqyrat Financiare*

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar dhe për një kontroll të brendshëm, të tillë siç drejtimi vendos se është i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale, të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi.

### *Përgjegjësia e Audituesve*

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare bazuar në auditimin tonë. Auditimi ynë u bë në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarte kërkojnë që ne t'u përmbahemi kërkesave etike të përshtatshme dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të fituar siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare nuk përmbajnë anomali materiale.

Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të siguruar evidencë që mbështet shumat dhe informacionet shpjeguese të dhëna në pasqyrat financiare. Procedurat e përzgjedhura janë në varësi të gjykimit tonë, përfshirë këtu vlerësimin e rreziqeve të anomalive materiale në pasqyrat financiare, prej gabimit apo mashtrimit. Në kryerjen e këtyre vlerësimeve të rrezikut, ne shqyrtojmë kontrollin e brendshëm, i cili është i rëndësishëm për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të pasqyrave financiare, me qëllim hartimin e procedurave të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat, por që nuk kanë për qëllim shprehjen e një opinionit për efektivitetin e kontrollit të brendshëm të njësisë ekonomike. Auditimi përfshin gjithashtu, vlerësimin e përshtatshmërisë së parimeve kontabël të përdorura dhe të çmuarjeve të rëndësishme të bëra nga drejtimi, si edhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë bazat për opinionin tonë.


### *Opinion*

Sipas opinionit tonë, pasqyrat e vaçanta financiare japin një pamje të vërtetë dhe të sinqertë për gjendjen financiare të pakonsoliduar të Shoqërisë me datë 31 dhjetor 2013, për rezultatin e saj financiar të pakonsoliduar dhe flukset e saj monetare të pakonsoliduara për vitin e mbyllur në atë datë, në pajtim me Standartet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

### **Raporte për rregullatorë të tjerë – kërkesë e Autoritetit të Mbikqyrjes Financiare të Shqipërisë për Marzhin e Aftësisë Paguese dhe Aktiveve në Mbulim të Rezervave Teknike.**

Në vijim të kërkesave të Autoritetit të Mbikqyrjes Financiare të Shqipërisë, ne kemi lexuar Skedulet Suplementare bashkëlidhur për Marzhin e Aftësisë Paguese dhe Aktivet në Mbulim të Rezervave Teknike (“Skedulet Suplementare”). Skedulet Suplementare të përgatitura nga drejtimi, nuk janë pjesë e pasqyrave financiare bashkëlidhur. Informacioni financiar historik, i paraqitur në Skedulet Suplementare të përgatitura nga drejtimi, është i qëndrueshëm, në të gjitha aspektet materiale me informacionin financiar vjetor, pasqyruar në pasqyrat financiare të Shoqërisë bashkangjitur më 31 dhjetor 2013, përgatitur në përputhje me legjislacionin kombëtar të kontabilitetit, të aplikueshëm për shoqëritë e sigurimit në Shqipëri. Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen e Skeduleve Suplementare, në përputhje me Ligjin nr. 9267 datë 29 korrik 2004 “Për Veprimtarinë e Sigurimit, të Risigurimit dhe Ndërmjetsimit në Sigurime dhe Risigurime”.

Steven Nutley  
Partner



KPMG Albania Sh.p.k.  
“Dëshmorët e Kombit” Blvd.  
Twin Towers Buildings  
Building 1, 13<sup>th</sup> floor  
Tirana  
Albania



**SiCRED sh.a.**

**Pasqyra të vecanta të pozicionit financiar më 31 dhjetor 2013**

*(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur është shprehur ndryshe)*

	Shënime	31 Dhjetor 2013	31 Dhjetor 2012
<b>AKTIVET</b>			
Mjete monetare në arkë dhe në bankë	8	8,214,561	12,735,772
Depozita me afat	9	566,075,863	531,464,944
Investime në filiale	10	52,281,670	36,230,170
Aktive të risigurimit	11	11,411,280	14,325,043
Pajisje	12	38,892,196	34,546,789
Llogari të arkëtueshme nga sigurimi dhe risigurimi, neto	13	378,834,777	351,979,323
Parapagime të tatim fitimit		4,833,116	12,138,433
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura	28	360,660	300,000
Shpenzimet e marrjes në sigurim të shtyra		7,944,105	3,532,927
Aktive të tjera	14	10,400,629	6,451,255
<b>TOTALI I AKTIVEVE</b>		<b>1,079,248,857</b>	<b>1,003,704,656</b>
<b>DETYRIMET</b>			
Detyrimet për humbjen dhe rregullimi i shpenzimeve për humbjen	15	11,175,873	5,481,534
Rezerva për primin e pafitur	16	112,177,772	97,207,896
Rezerva të tjera	17	82,278,052	65,377,116
Të ardhura të periudhave të ardhshme	13	317,439,691	268,088,840
Llogari të pagueshme sigurimi dhe risigurimi	13	693,106	5,279,439
Llogari të pagueshme ndaj institucioneve financiare	18	13,908,502	26,415,485
Llogari të pagueshme nga palët e lidhura	28	4,051,500	2,506,000
Detyrime të tjera	19	22,061,769	22,260,994
<b>Totali i Detyrimeve</b>		<b>563,786,265</b>	<b>492,617,304</b>
<b>KAPITALI</b>			
Kapitali i paguar	20.1	473,300,000	405,500,000
Kapitali nënshkruar, i paguar por i parregjistruar	20.2	3,700,000	67,800,000
Rezerva ligjore	20.3	1,916,149	1,916,149
Rezerva sigurimi	20.4	32,171,203	31,363,539
Fitim i mbartur		4,375,240	4,507,664
<b>Totali i Kapitalit</b>		<b>515,462,592</b>	<b>511,087,352</b>
<b>TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT</b>		<b>1,079,248,857</b>	<b>1,003,704,656</b>

Këto pasqyra të vecanta financiare janë aprovuar nga drejtimi i SiCRED sh.a. më 20 Qershor 2014 dhe janë firmosur nga:

Genc Koxhaj  
Drejtitor i Përgjithshëm

Teuta Locaj  
Dr. Dep Fin&Kontabilitet

Shënimet shprehur në faqet 6 deri 35 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave të vecanta financiare



**SiCRED sh.a.**

**Pasqyra të vecanta e fitim ose humbjeve dhe të ardhurave të tjera përmbledhese për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013**

*(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur është shprehur ndryshe)*

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2012
Të ardhura nga primet e shkruara bruto	21	220,765,611	207,263,993
Prime të shkruara ceduar risiguruesit	22	(14,857,305)	(16,768,337)
Prime të shkruara neto		<u>205,908,306</u>	<u>190,495,656</u>
Ndryshimi neto në rezervën e primeve të pafituara	16	(14,969,876)	(22,471,363)
Ndryshimi në rezerva të tjera	17	(16,900,936)	(17,200,777)
Ndryshimi në rezervën e risiguruesit	11	(2,913,763)	1,146,642
Ndryshimi në shpenzimet e marrjes në sigurim të shtyra		4,411,178	919,369
<b>Të ardhura neto nga primi i sigurimit</b>		<b><u>175,534,909</u></b>	<b><u>152,889,527</u></b>
Të ardhura nga investimet	23	29,849,497	28,960,681
Shpenzime financiare		(1,621,582)	(1,058,223)
Fitim/Humbje neto nga kursi i këmbimit		(1,171,652)	(822,259)
Të ardhura të tjera operative		12,537,152	12,520,665
<b>Totali i të ardhurave</b>		<b><u>215,128,324</u></b>	<b><u>192,490,391</u></b>
Shpenzime për humbjen dhe rregullimin e shpenzimeve për humbjen		(27,974,118)	(22,947,540)
Shpenzimet e marrjes në sigurim	24	(60,375,988)	(51,853,096)
Shpenzime administrative	25	(113,525,701)	(106,181,052)
Amortizimi	12	(7,931,457)	(5,930,460)
<b>Totali i shpenzimeve</b>		<b><u>(209,807,264)</u></b>	<b><u>(186,912,148)</u></b>
<b>Fitimi para tatimit</b>		<b><u>5,321,060</u></b>	<b><u>5,578,243</u></b>
Tatimi mbi fitimin	26	(945,820)	(1,070,579)
<b>Fitimi i vitit</b>		<b><u>4,375,240</u></b>	<b><u>4,507,664</u></b>
<b>Të tjera të ardhura përmbledhëse</b>		<b>-</b>	<b>-</b>
<b>Totali i të ardhurave përmbledhëse të vitit</b>		<b><u>4,375,240</u></b>	<b><u>4,507,664</u></b>

*Shënimet shoqëruese në faqet 6 deri 35 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave të vecanta financiare.*

SiCRED sh.a.

**Pasqyra të vecanta të lëvizjeve të kapitalit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013**

*(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur është shprehur ndryshe)*

	<b>Kapitali themeltar</b>	<b>Kapital i nënshkruar i paregjistruar</b>	<b>Rezerva ligjore</b>	<b>Rezerva të tjera</b>	<b>Fitime të pashpërndar a</b>	<b>Totali</b>
<b>Gjendja më 1 Janar 2012</b>	<b>405,500,000</b>	-	<b>1,916,149</b>	<b>25,425,569</b>	<b>77,637,970</b>	<b>510,479,688</b>
Fitimi neto i vitit	-	-	-	-	4,507,664	4,507,664
Të ardhura të tjera përmbledhëse, neto nga tatimi	-	-	-	-	-	-
<b>Totali i të ardhurave përmbledhëse</b>	-	-	-	-	<b>4,507,664</b>	<b>4,507,664</b>
<b>Transaksione me pronarët, të rregjistruara direkt në kapital</b>						
Rritje në kapitalin e paguar	-	67,800,000	-	-	(67,800,000)	-
Dividendë të paguar	-	-	-	-	(3,900,000)	(3,900,000)
Rritje në rezerva të tjera	-	-	-	5,937,970	(5,937,970)	-
<b>Totali i kontributeve dhe shpërndarje tek pronarët</b>	-	<b>67,800,000</b>	-	<b>5,937,970</b>	<b>(77,637,970)</b>	<b>(3,900,000)</b>
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2012</b>	<b>405,500,000</b>	<b>67,800,000</b>	<b>1,916,149</b>	<b>31,363,539</b>	<b>4,507,664</b>	<b>511,087,352</b>

*Shënimet shoqëruese në faqet 6 deri 35 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave të vecanta financiare.*

**SiCRED sh.a.****Pasqyra të vecanta të levizjeve të kapitalit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013 (vazhdim)***(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur është shprehur ndryshe)*

	<b>Kapitali themeltar</b>	<b>Kapital i nënshkruar i paregjistruar</b>	<b>Rezerva ligjore</b>	<b>Rezerva të tjera</b>	<b>Fitime të pashpërndar a</b>	<b>Totali</b>
<b>Gjendja më 1 janar 2013</b>	<b>405,500,000</b>	<b>67,800,000</b>	<b>1,916,149</b>	<b>31,363,539</b>	<b>4,507,664</b>	<b>511,087,352</b>
Fitimi neto i vitit	-	-	-	-	4,375,240	4,375,240
Të ardhura të tjera përmbledhëse, neto nga tatimi	-	-	-	-	-	-
<b>Totali i të ardhura përmbledhëse</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>4,375,240</b>	<b>4,375,240</b>
<b>Transaksione me aksionerët të njohura direkte në capital</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
Regjistrimi i kapitalit	67,800,000	(67,800,000)	-	-	-	-
Rritje në kapitalin e paguar	-	3,700,000	-	-	(3,700,000)	-
Dividendë të paguar	-	-	-	-	-	-
Rritje në rezerva të tjera	-	-	-	807,664	(807,664)	-
<b>Totali i kontributeve dhe shpërndarje tek pronarët</b>	<b>67,800,000</b>	<b>(64,100,000)</b>	<b>-</b>	<b>807,664</b>	<b>(4,507,664)</b>	<b>-</b>
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2013</b>	<b>473,300,000</b>	<b>3,700,000</b>	<b>1,916,149</b>	<b>32,171,203</b>	<b>4,375,240</b>	<b>515,462,592</b>

*Shënimet shoqëruese në faqet 6 deri 35 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave të vecanta financiare.*



**SiCRED sh.a.**

**Pasqyra të vecanta e fluksit të parasë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013**

*(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur është shprehur ndryshe)*

	Shënime	2013	2012
<b>Fluksi i parasë nga aktivitetet operative</b>			
<b>Fitimi para tatimit</b>		<b>5,321,060</b>	<b>5,578,243</b>
Rregullime për:			
Amortizimin		7,931,457	5,930,460
Nxjerrje jashtë përdorimi të aktiveve të qëndrueshme		452,388	1,491,590
Ndryshimi në rezervën për primet e pafituara		14,969,876	22,471,363
Ndryshimi në rezervën e risigurimit		2,913,763	(1,146,642)
Ndryshimi në rezerva të tjera		16,900,936	17,200,777
Ndryshimi në detyrimin për humbjen dhe rregullimin e shpenzimeve për humbjen		5,694,339	(603,095)
Zbritje për humbjet nga zhvlerësimi		-	31,040
Të ardhura nga investimet		(29,849,497)	(28,960,681)
<b>Flukset monetare të gjeneruara nga operacionet para ndryshimeve në aktivet dhe detyrimet operative</b>		<b>24,334,322</b>	<b>21,993,055</b>
Ndryshimi në aktivet dhe detyrimet operative:			
Rritje në shpenzimet e Marrjes ne Sigurim te shtyra		(4,411,178)	(919,369)
Të ardhura të shtyra për periudhat e ardhshme		49,350,851	102,389,337
Ndryshimi në llogaritë e arkëtueshme të sigurimit dhe risigurimit		(26,855,454)	(119,069,565)
Ndryshimi në aktivet e tjera		(3,949,374)	(835,453)
Ndryshimi në mjetet monetare të kushtëzuara		394,109	(196,110)
Ndryshimi në llogari të pagueshme të sigurimit dhe risigurimit		(4,586,333)	(652,886)
Ndryshimi në detyrime të tjera		(199,225)	3,583,315
Ndryshimi në llogari të pagueshme ndaj institucioneve financiare		(12,506,983)	26,415,485
Ndryshime në parapagime të tatim fitimit		7,305,317	(1,437,213)
Ndryshime në llogari të arkëtueshme me palët e lidhura		1,545,500	2,506,000
Ndryshime në llogari të pagueshme me palët e lidhura		(60,660)	(175,000)
Interesi i arkëtuar		30,430,770	29,732,714
Tatime të paguara		(945,820)	(1,070,579)
<b>Flukset monetare të gjeneruara nga operacionet</b>		<b>59,845,842</b>	<b>62,263,731</b>
<b>Flukset monetare për aktivitetet investuese</b>			
Investime në filiale		(16,051,500)	(15,106,000)
Blerjet e aktiveve të qëndrueshme		(12,729,252)	(19,191,839)
Rritja në depozita me afat		(35,192,192)	(21,851,212)
<b>Flukset monetare nga aktivitetet investuese</b>		<b>(63,972,944)</b>	<b>(56,149,051)</b>
<b>Flukset monetare nga aktivitetet financuese</b>			
Shpërndarje dividendësh		-	(3,900,000)
		-	<b>(3,900,000)</b>
<b>(Rënia)/Rritja neto për mjetet monetare dhe ekuivalente</b>		<b>(4,127,102)</b>	<b>2,214,680</b>
<b>Mjete monetare dhe ekuivalentë në fillim të vitit</b>	<b>8</b>	<b>12,341,663</b>	<b>10,126,983</b>
<b>Mjete monetare dhe ekuivalentë në fund të vitit</b>	<b>8</b>	<b>8,214,561</b>	<b>12,341,663</b>

*Shënimet shoqëruese në faqet 6 deri 35 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave të vecanta financiare.*



*(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur është shprehur ndryshe)*

## **1. TË PËRGJITHSHME**

SiCRED Sh.a (“Shoqëria”) u krijua më 7 tetor 2003 si një Shoqëri Sigurimi Jete me vendndodhje në Shqipëri. Shoqëria u liçensua nga Autoriteti Mbikqyrës i Sigurimeve (“Autoriteti”) dhe filloi aktivitetin e saj të sigurimit më 1 tetor 2004. Shoqëria ka degë të vendosura kryesisht në Tiranë, Durrës, Shkodër, Fier, Vlorë, Gjirokastrë, Elbasan, dhe Korçë. Tregu i Sigurimeve në Shqipëri është i rregulluar me anë të ligjit nr. 9267 datë 29.07.2004 “Mbi aktivitetin e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimin në sigurim dhe risigurim” të Republikës së Shqipërisë (“Ligji i Sigurimit”) dhe njësia rregullatore Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare (“Autoriteti”).

Më 1 Shkurt 2011, Shoqëria bleu 75% të aksioneve të Sigma IPP, emri i së cilës u ndryshua më pas në “Shoqëria Administruese e Fondit të Pensionit SiCRED sh.a” (“SiCRED Pension”). Filiali vepron si një shoqëri administruese për një fond kontributi të përcaktuar për mbledhjen dhe investimin e këtyre fondeve vullnetare, si dhe në procesimin e pagesave të pensioneve. bazuar “Fondi i Pensionit Vullnetar SiCRED Pensions” (“Fond i pensionit”) i cili edhe pse nuk kishte një formë ligjore, u liçensua nga Autoriteti më 21 Dhjetor 2011.

Gjate vitit 2013 u bene ndryshime ne kontributet e zoteruara te “shoqeria Administruese e Fondit te Pensionit SiCRED sha “ ku SiCRED sha nga 75% me 31 dhjetor 2013 zoteron 87.25%.

Më 29 Qershor 2012 në Asamblenë e Përgjithshme të Aksionerëve u vendos themelimi i SiCRED Assistance i cili është plotësisht pronë e Shoqërisë. Objektivi i tij është t’u sigurojë asistencë dhe shërbime konsulente kompanive për implementimin e legjislacionit dhe rregullave teknike për të siguruar mirëqenien e punonjësve, si dhe sigurimin e asistencës dhe konsulencës për të analizuar, identifikuar dhe për të parandaluar rreziqet në vendin e punës, në përputhje me kërkesat e legjislacionit përkatës.

Më 31 dhjetor 2013, Shoqëria kishte 47 punonjës dhe menaxherë të lartë (2012: 50).

## **2. BAZAT E PËRGATITJES**

### **a) Baza e Përputhshmërisë**

Pasqyrat financiare të vecanta janë përgatitur në bazë të Standarteve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF), lëshuar nga Bordi i Standarteve Ndërkombëtare të Kontabilitetit. Shoqëria përgatit pasqyrat financiare të vecanta dhe të konsoliduara. Pasqyrat financiare të vecanta bashkëngjitur janë përgatitur me qëllim të kerkësave mbikqyrëse, ndërsa pasqyrat financiare të vecanta janë aprovuar me 20 Qershor 2014 dhe janë të vlefshme pranë zyrave qendrore të Shoqërisë.

### **b) Baza e përgatitjes**

Pasqyrat të vecanta financiare janë përgatitur në bazë të parimit të kostos historike.

### **c) Monedha funksionale dhe e prezantimit**

Këto pasqyra të vecanta financiare janë të prezantuara në Lek, që është dhe monedha funksionale e Shoqërisë. Përveç rasteve ku specifikohet ndryshe, informacioni financiar është i prezantuar në Lek.

### **d) Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimit**

Përgatitja e pasqyrave të vecanta financiare kërkon që drejtuesit të kryejnë gjykime, vlerësime dhe supozime të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave kontabël dhe shumat e raportuara të aktivëve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga ato të vlerësimeve. Vlerësimet dhe bazat e llogaritjes rishikohen vazhdimisht. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimet rishikohen dhe për periudhat e ardhshme të cilat ndikohen. Në veçanti, informacion rreth fushave më kryesore për llogaritjen e pasigurisë dhe gjykimeve kritike në aplikimin e politikave kontabël që kanë efektin më të rëndësishëm në shumat e njohura në pasqyrat financiare vecanta përshkruhen në shënimet 7,13,15,16 dhe 17.

Politikat kontabël të vendosura më poshtë janë aplikuar në përputhje me të gjitha periudhat e paraqitura në këto pasqyra financiare të vecanta dhe janë aplikuar me konsistencë nga Shoqëria.



*(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur është shprehur ndryshe)***3. POLITIKA KONTABEL TE RËNDËSISHME****a) Konsolidimi i filialeve**

Filialet janë subjekte të kontrolluara nga Shoqëria. Kontrolli ekziston atëherë kur kompania ka pushtetin direkt ose indirekt të drejtë politikave financiare dhe operative të çdo subjekti për të arritur përfitime nga aktiviteti i tyre përkates. Në vlerësimin e kontrollit janë marrë parasysh të drejtat potenciale të votës të cilat janë aktualisht të ushtrueshme ose të konvertueshme.

Bazuar në kërkesat vendore mbi mbikqyrjen, Shoqëria është e nevojshme që të raportojë pasqyrat financiare të konsoliduara si dhe setin e plote të pasqyrave financiare të veçanta të shoqërisë mëmë. Aktivitetet e filialeve nuk konsolidohen në pasqyrat financiare të veçanta, por ato konsolidohen në pasqyrat financiare të konsoliduara të cilat janë në përputhshmëri me Standartet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) dhe janë të disponueshme për përdorim publik.

**b) Transaksionet në monedhë të huaj**

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale sipas kursit të këmbimit në datën e transaksionit. Fitimi ose humbja që vjen nga këmbimet valutore për këto transaksione dhe nga këmbimet me kursin e fundvitit njihen në pasyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kurset e këmbimit të përdorura më 31 dhjetor 2013 dhe 2012 janë kurset zyrtare të Bankës së Shqipërisë (Lek ndaj monedhave të huaja) të paraqitura si më poshtë.

	<b>31 dhjetor 2013</b>	<b>31 dhjetor 2012</b>
USD	101.86	105.85
EUR	140.20	139.59

**c) Klasifikimi i kontratave të sigurimit dhe investimeve**

Kontrata nën të cilat Shoqëria pranon të marrë një rrezik të rëndësishëm nga një palë tjetër (policë-mbajtësi) duke rënë dakort të kompensojë policë-mbajtësin për një ngjarje të caktuar të pasigurtë (ngjarja siguroese) e cila ka efekte negative dhe ndikon në policë-mbajtësin, janë klasifikuar si kontrata sigurimi. Rreziku i sigurimit është një rrezik ndryshe nga rreziku financiar. Rreziku financiar është rreziku i ndryshimeve të mundshme të ardhshme në një ose në disa norma interesi specifike, çmimet e letrave me vlerë, kursi i këmbimit, indeksat e çmimeve ose të normave, normat e kreditimit apo indeksat e kreditimit ose variabla të tjerë, të siguruar në rastin e variablave jo-financiare kur variabli nuk është specifik për një palë në kontratë. Kontratat e sigurimit mund të transferojnë një pjesë të rrezikut financiar.

*(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur është shprehur ndryshe)*

### **3. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)**

#### **d) Njohja dhe matja e kontratave**

##### *Primet*

##### *Primet për sigurimin e jetës*

Primet e shkruara bruto përfshijnë shumat e përfituara gjatë vitit financiar në lidhje me sigurimin e drejtpërdrejtë, pavarësisht nga fakti se shuma të tilla mund të lidhen tërësisht apo pjesërisht me një periudhë të mëvonshme në kontabilitet. Primet paraqiten bruto pa përfshirë komisionet e ndërmjetësve dhe taksat e bazuara në prime. Pjesa e fituar e primeve të pranuar njihet si e ardhur. Primet janë të fituara nga data e marrjes përsiper të rrezikut, përgjatë periudhës së sigurimit, bazuar në modelin e rrezikut të nënshkruar. Primet e jashtme të risigurimit njihen si shpenzim në përputhje me modelin e shërbimit të marrë nga risiguruesi. Nëse një policë sigurimi anulohet, primi i mbetur për t'u paguar përfshihet në të ardhurat nga primet.

Lëvizja e detyrimeve nga sigurimi, nëse ka ndonjë, njihet si e ardhur neto e pjesës së risiguruesit. Të ardhurat nga investimet paraqiten bruto. Interesi nga depozitat me afat dhe letrat me vlerë të investimeve përlllogaritet deri në fundin e cdo periudhe në mënyre proporcionale për periudhën e ardhshme.

##### *Rezerva për primin e pafituar*

Primet e pafituara janë llogaritur në përputhje me pagesat individuale të rinovueshme të biznesit Ato paraqesin atë pjesë të primeve të shkruara bruto i cili lidhet me mbulimin e sigurimit nga polica e lëshuar nga Shoqëria, e cila zgjat periudhat e ardhshme mbi datën e raportimit.

Shoqëria paraqet rezervën për primin e pafituar neto nga kostot e marrjes në sigurim. Nuk krijohet dhe paraqitet në mënyrë të veçantë asnjë Kosto e Shtyrë e Marrjes në Sigurim. Rezerva për primin e pafituar dhe rezerva e dëmeve nga periudhat e mëparshme njihet si e ardhur.

##### *Shpenzimet e shtyra të Marrjes në Sigurim*

Shpenzimet e shtyra të marrjes në sigurim janë shumat e kostove të blerjes të cilat zbriten kur llogaritet rezerva për primin e pafituar. Ato janë përcaktuar si pjesë e kostove të blerjes si përqindje e planit të sigurimit teknik dhe lidhen me periudha midis fundit të periudhës raportuese dhe datës së përfundimit të kontratës së sigurimit. Kostot aktuale të blerjes njihen plotësisht si shpenzim në periudhën aktuale.

##### *Dëmet*

##### *Dëmet për sigurimin e jetës*

Dëmet e lindura përbehen nga pagesat e bëra gjatë vitit financiar së bashku me ndryshimin në provigjon për dëmet e ndodhura gjatë vitit. Dëmet bruto të paguara përfshijnë të gjitha shpenzimet e bëra për këto dëme.

##### *Provigjionet për dëmet*

Provigjionet për dëmet janë shumat e të gjitha dëmeve që kanë lindur gjatë periudhës financiare aktuale dhe të mëparshme të cilat nuk janë paguar në përfundim të vitit fiskal. Provigjioni përfshin dëmet e ndodhura, por të paraportuara, të cilat llogariten duke përdorur metodat e trekëndëshit.

##### *Biznesi afatgjatë (Rezerva të tjera)*

Rezervat e biznesit afatgjatë lidhen me produktin e Jetës me Kursim dhe matet si shuma e plotë e fondit të akumuluar në datën e raportimit.



*(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur është shprehur ndryshe)*

### **3. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)**

#### **d) Njohja dhe matja e kontratave (vazhdim)**

##### *Risigurimi*

Shoqëria cedon risigurimin në rrjedhën normale të biznesit me qëllim që të limitojë humbjen neto nëpërmjet diversifikimit të rrezikut. Marrëveshjet e risigurimit nuk i heqin Shoqërisë detyrimet ndaj policëmbajtësve. Primet e ceduara dhe përfitimet e rimbursimit paraqiten në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve dhe pasqyrën e pozicionit financiar me baza bruto.

Kontratat nga të cilat lind një transferim i rrezikut të sigurimit kontabilizohen si risigurim. Shumat e rigjeneruara nga këto kontrata njihen në të njëjtin vit me dëmin.

Aktivet e risiguara përfshijnë balanca detyrimi nga shoqëria risiguroese për detyrimet e primeve të ceduara si dhe shuma të rikuperueshme nga dëmet e paguara. Këto shuma, nëse ka të tilla, klasifikohen si shuma të arkëtueshme dhe paraqiten në pasqyrat financiare të veçantë.

Shumat e rigjeneruara në kontratat e risigurimit llogariten për zhvlerësim në çdo datë. Këto aktive zhvlerësohen nëse ka evidencë objektive, si pasojë e një ngjarje që ka lindur pas njohjes fillestare, për të cilat Shoqëria nuk mund të rimarrë të gjitha shumat që i detyrohen dhe për një ngjarje e cila ka një impakt të matur në mënyrë të besueshme për shumat të cilat Shoqëria do të marrë nga risiguroesi.

##### *Testi i mjaftueshmërisë së rezervës*

Në çdo datë raportimi Shoqëria bën një test të mjaftueshmërisë së rezervës i cili i jep Shoqërisë një vlerësim nëse detyrimet e sigurimit të cilat janë njohur janë të mjaftueshme. Gjithashtu, testet e kryera përfshijnë Analizën e Raportit të Dëmeve dhe Analizën e Zhvillimit të provigjioneve të dëmeve.

Analiza e raportit të dëmeve kryhet çdo vit individualisht për të gjitha produktet kryesore të biznesit. Llogaritja bëhet vetëm mbi dëmet, si dhe mbi dëmet duke përfshirë kostot e blerjes dhe ndonjë kosto tjetër të jashtme si kostoja e mirëmbajtjes. Për të kryer këtë analizë, Shoqëria merr parasysh parashikimet për daljet e flukseve të parave. Shoqëria nuk i skonton këto flukse parash sepse shumica e dëmeve priten të shlyhen brenda vitit.

Gjithashtu, Shoqëria bën edhe Analizën e Zhvillimit të provigjioneve të dëmeve për të vlerësuar metodologjinë e saj të përcaktimit të rezervave. Kjo analizë kryhet në mënyrë të veçantë ,por dhe të kombinuar për RBNS (të raportuara, por ende të pambyllura) dhe IBNR (të ndodhura ,por të paraportuara). Nëse analiza nxjerr në pah mospërputhje të mëdha, Shoqëria kryen rregullime në metodologjinë e përdorur. Nëse identifikohet një mungesë ajo ngarkohet menjëherë në fitim ose humbje duke krijuar një provigjion për riskun e paskaduar nga humbjet që dalin nga testi i mjaftueshmërisë së rezervës.

#### **e) Instrumentat financiarë**

##### *(i) Njohja*

Shoqëria fillimisht njeh kreditë dhe depozitat në datën kur lindin të drejtat dhe detyrimet përkatëse. Të gjitha detyrimet dhe aktivet financiare njihen në datën e transaksionit sipas së cilit Shoqëria bëhet palë e detyrimeve kontraktore të instrumentit.

##### *(ii) Klasifikimi*

Shiko politikat kontabël 3(f),(g) dhe (h).

##### *(iii) Ç'registrimi*

Shoqëria ç'registron një aktiv financiar nëse humbet kontrollin mbi flukset e ardhshme të parasë ose transferon të drejtat për të marrë flukset kontraktuale të parasë nga aktivet financiare në transaksione në të cilat i gjithë rreziku dhe përfitimet nga aktivet financiare është transferuar. Çdo interes nga aktivi financiar i transferuar që është krijuar ose mbajtur nga Shoqëria njihet si aktiv ose detyrim i veçantë.

Shoqëria ç'registron një detyrim financiar kur detyrimet kontraktuale shuhet, anulohen ose maturohen.



*(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur është shprehur ndryshe)*

### **3. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)**

#### **e) Instrumentat financiarë (vazhdim)**

*(iv) Netimi*

Aktivitet dhe detyrimet financiare mund të netohen dhe tepricat neto të paraqiten në bilanc vetëm kur Shoqëria ka të drejta ligjore për të netuar shumat dhe ka qëllim të arkëtojë ose të mbylli aktivin apo detyrimin neto në të njëjtën kohë.

Të ardhurat dhe shpenzimet paraqiten të netuara kur lejohet nga Standartet e Kontabilitetit, ose për fitime dhe humbje që lindin nga transaksione me natyrë të njëjtë përgjatë aktivitetit të Shoqërisë.

*(v) Matja me kosto të amortizuar*

Kosto e amortizuar e një aktivi financiar është vlera me të cilën aktivi financiar ose detyrimi financiar është matur në njohjen fillestare, duke zbritur këstet e paguara, plus ose minus amortizimin kumulativ që rezulton nga përdorimi i metodës së interesit efektiv duke marrë parasysh ndonjë diferencë midis vlerës së njohur në fillim dhe vlerës në maturim si dhe humbjet nga rënia në vlerë.

*(vi) Matja me vlerë të drejtë*

Përcaktimi i vlerës së drejtë të aktiveve dhe detyrimeve financiare është bazuar në çmimet e publikuara të tregut dhe treguesve të instrumentave financiare në tregjet aktive. Për të gjithë instrumentat financiarë të tjerë vlera e drejtë është përcaktuar duke përdorur teknika vlerësimi. Teknikat e vlerësimit përfshijnë teknika të tilla si vlera reale neto, metoda e aktualizimit të flukseve, krahasimi me instrumenta të tjerë të ngjashëm për të cilat çmimet përcaktohen në tregje aktive, si dhe modele të tjera vlerësimi.

*(vii) Identifikimi dhe matja e rënies në vlerë*

Në datën e përgatitjes së pasqyrave financiare të vecanta Shoqëria vlerëson nëse ka evidenca objektive për rënien në vlerë të aktiveve financiare. Aktivitet financiarë pësojnë rënie në vlerë kur evidenca objektive dëshmon që një ngjarje me pasojë humbje ka ndodhur pas vlerësimit të mëparshëm të aktivitetit, si dhe kjo ngjarje ndikon në flukset e mjeteve monetare të vlerësueshme në mënyrë të besueshme.

Shoqëria merr në konsideratë evidenca për rënien në vlerë të aktiveve financiare specifike ose në grup të aktiveve. Të gjitha aktivitet individualisht të rëndësishme testohen veçmas për humbjen e mundshme në vlerë, por që nuk është identifikuar ende. Të gjitha aktivitet që nuk konsiderohet të jenë individualisht të rëndësishëm grupohen dhe vlerësohen së bashku me aktive me karakteristika të ngjashme (të mbajtura me kosto të amortizuar) për rënie në vlerë.

Si evidencë objektive për rënie në vlerë të mundshme të aktiveve në pasqyrat financiare të vecanta mund të përmendet mosshlyerja në kohë apo shkelja e termave nga një debitor, ristrukturimi i një kredie/paradhënie të dhënë nga Shoqëria me terma të cilat në kushte të tjera nuk do të ishin konsideruar, tregues për falimentimin e mundshëm të një debitori ose të dhëna të tjera të dukshme lidhur me një grup aktiveve si ndryshimi në përkeqësim në statusin e arkëtueshmërisë së një debitori ose kreditori, apo kushte ekonomike që ndikojnë në përkeqësim të grupit të aktiveve.

#### **f) Mjetet monetare dhe ekuivalente me to**

Mjetet monetare dhe ekuivalentë me to përfshijnë balancat e gjendjes në arkë, mjetet monetare të depozituara në banka të nivelit të dytë dhe investime afatshkurtra me likuiditet të lartë dhe me maturitet deri në tre muaj ose më pak që nga momenti i blerjes.

#### **g) Depozitat me afat**

Depozitat me afat paraqiten në pasqyrën e pozicionit financiar me shumën e principalit të tyre dhe klasifikohen sipas maturitetit. Depozitat me afat me maturitet më të vogël se tre muaj klasifikohen si ekuivalentë të mjeteve monetare, ato me maturitet midis tre dhe dymbëdhjetë muaj klasifikohen si



(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur është shprehur ndryshe)

investime në depozita me afat. Interesi llogaritet në bazë rrjedhëse dhe interesi i arkëtueshëm pasqyrohet në llogaritë e tjera të arkëtueshme.

### 3. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

#### h) Letrat me vlerë

Letrat me vlerë janë investime borxhi të cilat Shoqëria ka për qëllim dhe aftësi t'i mbajë deri në maturim dhe që janë klasifikuar si aktive të mbajtura deri në maturim. Investimet të cilat kanë pagesa fikse ose të përcaktuara dhe të cilat synohen të mbahen deri në maturim dhe si rrjedhim maten me kosto të amortizuar, minus provigjionin për rënien në vlerë. Kosto e amortizimit llogaritet duke marrë në konsideratë ndonjë skontim ose prim në blerje. Primet dhe skontimet në investimet e projektuara si të mbajtura deri në maturim amortizohen sistematikisht gjatë maturitetit duke përdorur metodën e interesit efektiv dhe rregjistrohen si të ardhura nga interesi.

#### i) Pajisje

##### (i) Njohja dhe matja

Zërat e pajisjeve maten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet nga zhvlerësimi. Kostot përfshijnë shpenzime të cilat lidhen direkt me koston e blerjes së aktiveve. Kostoja e aktiveve të ndërzuara vetë përfshin koston e materialeve dhe punën direkte, çdo kosto tjetër që lidhet me vënien e aktivitetit në punë, dhe kostot e rregullimit të vëndit në të cilin ato do të vendosen. Blerja e programeve kompjuterike të cilat janë pjesë integrale e funksionimit të pajisjes kapitalizohet si pjesë e pajisjes. Kur pjesë të një zëri të pajisjeve kanë jetëgjatësi të ndryshme ato kontabilizohen si zëra të ndarë (përbërësit kryesor) të pajisjeve.

##### (ii) Kostot e mëvonshme

Në vlerën e mbartur të një njësie të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara Shoqëria njeh kostot e zëvendësimit të një pjese të kësaj njësie kur ka ndodhur kjo kosto, në qoftë se është e mundur që përfitimet e ardhshme ekonomike të trupëzuara tek njësia t'i shkojnë Shoqërisë dhe kostoja e njësisë të mund të matet me besueshmëri. Të gjitha kostot e tjera njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve si një shpenzim në momentin që ndodh.

##### (iii) Amortizimi

Amortizimi njihet në pasyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e vlerës në rënie mbi jetëgjatësinë e parashikuar të aktiveve. Aktivitetet e marra me qera amortizohen mbi periudhën më të shkurtër mes kohëzgjatjes së termave të kontratës së qerasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit. Veprat e artit nuk amortizohen. Normat e vlerësuara të zhvlerësimit janë si më poshtë:

Ndërtesa (Kioska)	5%
Mobilje dhe pajisje zyra	20%
Kompjuterat	25%
Mjete transporti	20%
Përmirësime në ambjentet e marra me qera	Sipas afatit të kontratës së qerases

#### j) Zhvlerësimi i aktiveve jo-financiare

Vlera kontabël e aktiveve jo-financiare të Shoqërisë shqyrtohet në çdo datë bilanci për të përcaktuar nëse ekziston ndonjë tregues për rënie në vlerë të aktivitetit. Në qoftë se ekziston ndonjë tregues i tillë, vlera kontabël vlerësohet.

Një humbje nga rënia në vlerë njihet kurdoherë që vlera e mbartur e një aktiviteti ose njësie e tij e gjenerimit të parasë tejkalon shumën e tij të rikuperueshme. Njësi para-gjeneruese është njësie më e vogël e identifikueshme e grupimit të aktiveve që gjeneron flukse monetare të pavarura nga aktive dhe grupe të tjera. Humbja nga rënia në vlerë njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Vlera e rikuperueshme e një mjeti ose një njësie para-gjeneruese është vlera më e lartë midis vlerës së përdorimit dhe vlerës reale pasi janë zbritur kostot e shitjes. Në përafrimin e vlerës në përdorim, flukset e pritshme për t'u arkëtuar aktualizohen duke përdorur një normë të rregulluar për efektin e taksës që



*(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur është shprehur ndryshe)*

reflekton vlerësime të krahasueshme me tregun të vlerës në kohë të parasë si dhe risqeve që lidhen me aktivin.

### **3. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)**

#### **j) Zhvlerësimi i aktiveve jo-financiare (vazhdim)**

Humbjet nga rënia në vlerë të njohura në periudhat e mëparshme vlerësohen në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse humbja është zvogëluar apo nuk ekziston më. Një humbje nga rënia në vlerë rimerret nëse ka pasur një ndryshim në vlerësimet e përdorura për të përcaktuar shumën e rikuperueshme. Humbja nga rënia në vlerë rimerret vetëm deri në atë masë sa vlera kontabël e aktivitetit e cila nuk tejkalon vlerën kontabël që do të përcaktohej duke i zbritur amortizimin, në qoftë se nuk do të kishte qënë humbje nga zhvlerësimi i njohur.

#### **k) Llogaritë e arkëtueshme**

Llogaritë e arkëtueshme të sigurimit dhe të tjera llogari të arkëtueshme paraqiten në koston e tyre minus provigjonet për llogaritë e arkëtueshme të dyshimta. Llogaritë e arkëtueshme të sigurimit vlerësohen për zhvlerësim në çdo datë raportimi.

#### **l) Kapitali aksioner**

Kapitali aksioner njihet në vlerë nominale.

#### **m) Njohja e të ardhurave**

Politikat kontabël për njohjen e të ardhurave nga kontratat e sigurimit janë paraqitur në notën 3.d.

#### **n) Shpenzimet**

*Pagesat e qerasë operative*

Pagesat e bëra për qeranë operative njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën lineare përgjatë periudhës së qerasë. Nxitësit e qerasë të përfituar njihen në pasqyrë si pjesë integrale e shpenzimit total të qerasë.

#### **o) Shpenzimet e marrjes në sigurim**

Shpenzimet e marrjes në sigurim përcaktohen si kosto që rrjedhin nga blerja e kontratave të reja të sigurimit, duke përfshirë edhe kostot direkte, të tilla si komisionet e blerjes dhe kostot e krijimit të dokumentit të sigurimit dhe pjesën e shpenzimeve administrative që lidhen me procesin e propozimit dhe emetimit të policave. Shpenzimet e marrjes në sigurim njihen si shpenzime kur lindin.

#### **p) Përfitimet e punonjësve**

*(i) Kontributet*

Shoqëria paguan vetëm kontributet e detyrueshme për sigurimet shoqërore që i sigurojnë punonjësve përfitime pensioni kur këta të fundit dalin në pension. Autoritetet respektive të sigurimeve shoqërore të çdo juridiksioni legal kanë përgjegjësinë të sigurojnë kufirin e minimumit legal të pagesës për pension nën skemën e planit të pensionit me kontribute të përcaktuara. Kontributet e Shoqërisë për planin e përfitimit të pensionit njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në momentin që ato lindin.

*(ii) Leja vjetor e paguar*

Shoqëria njihet si detyrim shumë e pa skontuar të kostove të parashikuara në lidhje me lejen vjetore që pritet të paguhet në shkëmbim të shërbimeve të punonjësve për periudhën e përfunduar.

#### **q) Qeratë**

Qeratë, në të cilat një pjesë e mirë e rrezikut dhe përfitimeve të pronësisë mbahen nga qeradhënesi klasifikohen si qera operative. Pagesat e bëra për qeratë operative njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në bazë lineare për të gjithë periudhën e qerasë.



### **3. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)**

#### **r) Tatimi**

Tatimi mbi fitimin apo humbja për vitin pëfshin tatimin aktual dhe atë të shtyrë. Tatimi mbi fitimin njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me përjashtim të pjesës që lidhet me zëra të njohur në mënyrë direkte në kapital ose në pasqyrën e të ardhurave përmbledhëse.

Tatimi aktual është tatimi i pritshëm i pagueshëm mbi fitimin e tatueshëm të vitit, duke përdorur normat e tatimit në datën e raportimit. Tatimi mbi fitimin llogaritet duke axhustuar fitimin statutor përpara taksave për disa zëra të të ardhurave dhe shpenzimeve siç kërkohet nga Ligji Shqiptar.

Tatimi i shtyrë njihet për sa i përket diferencave të përkohëshme ndërmjet vlerës kontabël të aktiveve dhe detyrimeve për qëllim raportimi financiar dhe vlerave të përdoruar për qëllim tatimor. Tatimi i shtyrë matet me normat e tatimit që pritet të aplikohen ndaj diferencave të përkohshme kur ato kthehen mbrapsht, bazuar në ligjet që janë në fuqi ose në fuqi në mënyrë të konsiderueshme në datën e raportimit.

Një aktiv tatimor i shtyrë njihet për aq sa është e mundur që fitimi i tatueshëm i ardhshëm do të jetë i disponueshëm kundrejt të cilit të mund të përdoret. Tatimi i shtyrë rishikohet çdo datë raportimi dhe zvogëlohet deri në masën sa nuk ka më mundësi që përfitimi nga tatimi mund të realizohet.

#### **s) Standartet e reja dhe interpretimet të cilat nuk janë adoptuar akoma**

Një numër i ri standartesh, amendimesh dhe interpretimesh të cilët nuk kanë qenë akoma në fuqi për periudhën pas 1 janarit 2013, nuk janë aplikuar më herët në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare të vecanta. Ky fakt nuk pritet të ketë ndonjë efekt të rëndësishëm në këto pasqyra financiare, përveç SNRF 9 Instrumentat Financiarë, i cili do të jetë i detyrueshëm për tu aplikuar në pasqyrat financiare të Shoqërisë të vitit 2015 dhe mund të ndryshojë klasifikimin dhe matjen e aktiveve financiare. Shoqëria nuk planifikon ta implementojë këtë standart më herët dhe ndikimi që ai mund të ketë nuk është përcaktuar ende.



#### **4. MENAXHIMI I RREZIQEVE TË SIGURIMIT**

##### **a) Objektivat e menaxhimit të rreziqeve dhe politikat për të ulur rrezikun e sigurimit**

Rreziku nga kontratat e sigurimit është mundësia që ngjarja e siguruar ndodh dhe pasiguria për shumën e dëmit. Për vetë natyrën e kontratave të sigurimit, ky rrezik është i zakonshëm dhe i paparashikueshëm. Shoqëria e pranon rrezikun nga sigurimi nëpërmjet kontratave të sigurimit dhe disa kontratave të investimeve ku ajo supozon rrezikun e humbjes nga personat ose organizatat që janë të lidhura direkt me humbjen. Shoqëria është e ekspozuar ndaj pasigurisë së kohës, frekuencës dhe ashpërsisë së dëmeve nën këto kontrata.

Risigurimi blihet nga Shoqëria për të ulur rrezikun potencial nga humbjet si pasojë e ngjarjeve të mëdha individuale ose katastrofa dhe gjithashtu për të patur akses nga specialistë të rreziqeve dhe asistencë në menaxhimin e kapitalit. Policat e risigurimit nënshkruhen me risigurues të aprovuar në bazë proporcionale ose në bazë të marrveshjeve për humbjen.

Kapitali rregullator menaxhohet (por jo vetëm) duke iu referuar rrezikut të sigurimit ndaj të cilit Shoqëria është e ekspozuar. Për një portofol të kontratave të sigurimit ku teoria e propabilitetit është aplikuar për vendosjen e çmimit dhe provigjonimin, rreziku kryesor që Shoqëria ka nga kontratat e saj të sigurimit është se dëmet aktuale dhe pagesat e përfituesit janë më të mëdha se vlera e mbartur e detyrimeve të sigurimit. Kjo mund të lindë sepse frekuenca ose ashpërsia e dëmit dhe përfitimit janë më të mëdha se llogaritja. Ngjarjet e sigurimit janë të rastësishme dhe numri aktual i dëmeve dhe përfitimeve mund të ndryshojë nga viti në vit nga niveli i caktuar nga teknikat statistikore. Eksperiencia tregon se sa më i madh të jetë portofoli i kontratave të njëjta të sigurimit aq më e vogël do të jetë varianca relative e rezultateve. Gjithashtu, një portofol i diversifikuar më shumë ka më pak mundësi që të ndikohet nga ndryshimet në portofol.

##### **b) Strategjia e marrjes në sigurim**

Shoqëria ka zhvilluar strategjinë e saj të marrjes në sigurim duke diversifikuar llojin e rreziqeve të cilat ajo pranon dhe brënda secilës kategori të arrijë një popullatë rreziku relativisht të madhe për të ulur lëvizshmërinë e rezultateve të pritshme.

##### **c) Termat dhe kushtet e kontratave të sigurimit**

Termat dhe kushtet e kontratave të sigurimit të cilat kanë një efekt material mbi vlerën, kohën dhe pasigurinë e flukseve të ardhshme të parasë janë paraqitur më poshtë.

Natyra e rrezikut të mbuluar

Përgjithësisht, të gjitha produktet e Shoqërisë mbulojnë rrezikun e vdekshmërisë të tilla si paaftësitë e përkohshme ose të përhershme, mbulimin e shpenzimeve mjekësore, shpenzimet spitalore dhe të riaftësimit. Produktet e tjera nga Jeta e Debitorit dhe Jetës me Kursim kanë karakteristika të njëjta të produkteve me afat të shkurtër dhe janë të rinovueshme çdo vit me opsionin për të ndryshuar primin nga Shoqëria.

Policat e jetës me kursim përmbajnë elemente kursimi dhe rreziku. Përfitimi në rast vdekje është i barabartë me pjesën e rezervës për kursimin dhe shumën e siguruar e cila është nga 1,000 Euro deri në 10,000 Euro . Përfitimi në rast maturimi është i barabartë me pjesën e rezervës për kursimin. Primi është i ndarë në dy pjesë, pjesa e rrezikut e vendosur në fillim të kontratës dhe pjesa e kursimit.

Policat e sigurimit për shëndetin dhe të tjera kategori paraqesin polica me afat pa elemente kursimi dhe vlerë të kthyeshme. Përfitimi nga policat e sigurimit të shëndetit paguhet në rast vdekje të të siguruarit ose paaftësie të përkohshme ose të përhershme brenda një periudhe specifike.

(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur është shprehur ndryshe)

**4. MENAXHIMI I RREZIQEVE TË SIGURIMIT (VAZHDIM)****d) Risigurimi dhe përqëndrimi i rrezikut**

Risigurimi përdoret për të menaxhuar rrezikun e sigurimit. Megjithatë kjo nuk heq përgjegjesinë e Shoqërisë si sigruesi kryesor. Nëse risigruesi nuk paguan një dëm për arsye të ndryshme, Shoqëria është e detyruar që të paguajë policëmbajtësin për detyrimin. Shoqëria ka ceduar rrezikun e sigurimit për të limituar ekspozimin ndaj humbjeve dhe për të minimizuar efektin e humbjeve nga sigurimi i jetës për kreditë nëpërmjet marrveshjeve risigruese. Tabela e mëposhtme paraqet përfitimet e agreguara të fundvitit për kontratat e sigurimit të jetës së kredimarrësve sipas moshës për 31 dhjetorin 2013 dhe 2012. Analiza e ekspozimit kontraktual konsiderohet si treguesi më i mirë për përqëndrimin e rrezikut të sigurimit.

<b>Mosha për Sigurimin e Jetës së Kredimarrësve</b>	<b>31 dhjetor 2013</b>	<b>%</b>
Deri në 29	3,273,795,709	13%
30 – 39	5,971,896,798	23%
40 – 49	10,342,166,511	40%
50 – 59	5,844,947,722	23%
Mbi 60	393,651,364	2%
<b>Totali</b>	<b>25,826,458,104</b>	<b>100%</b>

<b>Mosha për Sigurimin e Jetës së Kredimarrësve</b>	<b>31 dhjetor 2012</b>	<b>%</b>
Deri në 29	3,116,080,962	11%
30 – 39	7,496,597,940	26%
40 – 49	11,650,340,333	41%
50 – 59	5,446,595,685	19%
Mbi 60	970,924,059	3%
<b>Totali</b>	<b>28,680,538,979</b>	<b>100%</b>

**e) Ekspozimi që lidhet me ngjarjet katastrofike**

Shoqëria merr në konsideratë se gjatë aktivitetit të saj të sigurimit ajo nuk ka akumuluar ekspozim që lidhet me ngjarjet katastrofike.



*(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur është shprehur ndryshe)*

## **5. MENAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR**

Transaksionet me instrumentat financiarë rezultojnë për Shoqërinë që të llogarisë rrezikun financiar. Këto përfshijnë rrezikun e tregut, rrezikun e kredisë (duke përfshirë rrezikun e kredisë nga risiguruesi) dhe rrezikun e likuiditetit. Secili nga këto rreziqe është i përshkruar më poshtë së bashku me një përmbledhje të mënyrave se si Shoqëria i menaxhon këto rreziqe.

### **Rreziku i tregut**

Rreziku i tregut përfshin tre lloje rreziqesh:

Rreziku valutor – rreziku që vlera e instrumentave financiarë do të variojë nga ndryshimet në kurset e këmbimit.

Rreziku i vlerës së drejtë të normës së interesit – rreziku që vlera e instrumentave financiare do të variojë nga ndryshimet në treg të normës së interesit.

Rreziku i çmimit – rreziku që vlera e instrumentave financiare do të variojë si rezultat i ndryshimeve të çmimeve të tregut, qofshin këto ndryshime si rezultat i faktorëve specifik të instrumentit financiar ose faktorë që ndikojnë të gjithë instrumentat financiarë që janë në treg.

Rreziku i tregut nuk përfshin vetëm mundësinë për të humbur, por edhe mundësinë për të fituar.

### ***Përputhja aktive/detyrim***

Shoqëria i menaxhon aktivet duke përdorur një mënyrë që balancon cilësinë, diversifikimin, përputhjen aktive-detyrim, likuiditetin dhe të ardhurat nga investimet. Qëllimi i procesit të investimit është që të optimizojë të ardhurat nga investimi ndërkohë që siguron që aktivet dhe detyrimet janë menaxhuar në bazë të fluksit të parave dhe zgjatjes së tyre.

Natyrë e rrezikut të sigurimit, maturimi i tyre dhe struktura e monedhës së vendosur për të shprehur detyrimin kanë një ndikim tek strategjia e investimit të Shoqërisë. Gjithashtu Shoqëria duhet të plotësojë limitet e vendosura nga rregulluesit e sigurimeve të cilët kërkojnë që aktivet financiare të investuara në institucionet jo-financiare nuk duhet të kalojnë limitin prej 10% të kapitalit aksioner.

Shoqëria vendos objektiva për portofol akivesh për çdo produkt sigurimi, gjë që përfaqëson strategjinë e investimit të përdorur për të financuar detyrimet brënda niveleve të pranueshme të rrezikut. Këto strategji përfshijnë objektiva për kohëzgjatjen, ndjeshmërinë, likuiditetin, përqëndrimin e sektorit të aktiveve dhe cilësinë e kreditit. Llogaritjet e përdorura për të përcaktuar sasitë e përafërta dhe kohën e pagesave të detyrimeve ndaj të siguruarve vlerësohen rregullisht.

Shumica e këtyre llogaritjeve janë subjektive dhe mund të ndikojnë në aftësinë e Shoqërisë për të arritur objektivat e menaxhimit të aseteve/detyrimeve. Shoqëria ka ndërmarrë disa transaksione në monedhë të huaj. Kështu që, ekspozimi ndaj lëvizjeve në kursin e këmbimit rritet.

Shoqëria ka ekspozim minimal ndaj rrezikut valutor sepse aktivet financiare të Shoqërisë përputhen kryesisht me të njëjtat monedha me detyrimet e sigurimit dhe kontratat e investimeve. Si rezultat, rreziku nga këmbimet valutore lind nga aktive dhe detyrime të tjera në monedha të tjera.



**Shënime të pasqyrave financiare të vecanta për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013***(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur është shprehur ndryshe)***5. MENAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)****a) Menaxhimi i rrezikut të këmbimeve valutore**

Aktivet dhe detyrimet në monedhë të huaj më 31 dhjetor 2013 janë si më poshtë (të konvertuara në Lek):

	Në LEK	Në EUR	Në USD	Totali
<b>Aktivet</b>				
Mjete monetare në arkë dhe bankë	5,284,970	2,886,568	43,023	8,214,561
Depozitat me afat dhe të ardhurat nga interesi	369,210,335	153,427,904	43,437,624	566,075,863
Aktivet e risigurimit	2,488,167	8,717,356	205,757	11,411,280
Investime ne filial	34,183,270	18,098,400	-	52,281,670
Të arkëtueshme nga sigurimi dhe risigurimi	171,869,376	205,759,337	1,206,064	378,834,777
Kosto të shtyra të blerjes	7,944,105	-	-	7,944,105
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura	360,660	-	-	360,660
Parapagime të tatim fitimit	4,833,116	-	-	4,833,116
Aktive të tjera	8,795,192	1,605,437	-	10,400,629
<b>Totali i aktiveve</b>	<b>604,969,191</b>	<b>390,495,002</b>	<b>44,892,468</b>	<b>1,040,356,661</b>
<b>Detyrimet</b>				
Detyrime për humbjet dhe rregullimet për humbjet	8,054,920	3,120,953	-	11,175,873
Primi i pafitur	52,035,001	59,488,116	654,655	112,177,772
Rezerva të tjera	-	82,278,052	-	82,278,052
Të ardhura të shtyra per periudhat e ardhshme	126,582,593	189,673,230	1,183,868	317,439,691
Detyrime për sigurimin dhe risigurimin	44,880	646,494	1,732	693,106
Detyrime për institucionet financiare	-	13,908,502	-	13,908,502
Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura	4,051,500	-	-	4,051,500
Detyrime të tjera	11,957,228	10,103,318	1,223	22,061,769
<b>Totali i detyrimeve</b>	<b>202,726,122</b>	<b>359,218,665</b>	<b>1,841,478</b>	<b>563,786,265</b>
<b>Pozicioni neto</b>	<b>402,243,069</b>	<b>31,276,337</b>	<b>43,050,990</b>	<b>476,570,396</b>

SiCRED sh.a.

**Shënime të pasqyrave financiare të vecanta për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013**

*(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur është shprehur ndryshe)*

**5. MENAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)**

**a) Menaxhimi i rrezikut të këmbimeve valutore (vazhdim)**

Aktivitet dhe detyrimet në monedhë të huaj më 31 dhjetor 2012 janë si më poshtë (të konvertuara në Lek):

	Në LEK	Në EUR	Në USD	Totali
<b>Aktivitet</b>				
Mjete monetare në arkë dhe bankë	11,055,749	1,574,891	105,132	12,735,772
Depozitat me afat	350,726,777	135,555,473	45,182,694	531,464,944
Aktivitet e risigurimit	2,305,277	11,580,806	438,960	14,325,043
Investime në filiale	18,131,770	18,098,400	-	36,230,170
Të arkëtueshme nga sigurimi dhe risigurimi	186,091,342	165,164,417	723,564	351,979,323
Kosto të shtyra të blerjes	771,064	2,761,863	-	3,532,927
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura	300,000	-	-	300,000
Parapagime të tatim fitimit	12,138,433	-	-	12,138,433
Aktive të tjera	5,722,382	728,873	-	6,451,255
<b>Totali i aktiveve</b>	<b>587,242,794</b>	<b>335,464,723</b>	<b>46,450,350</b>	<b>969,157,867</b>
<b>Detyrimet</b>				
Detyrime për humbjet dhe rregullimet për humbjet	2,360,581	3,120,953	-	5,481,534
Primi i pafitur	46,356,485	50,398,690	452,721	97,207,896
Rezerva të tjera	-	65,377,116	-	65,377,116
Të ardhura të shtyra për periudhat e ardhshme	110,598,789	156,850,353	639,698	268,088,840
Detyrime për sigurimin dhe risigurimin	202,321	5,048,538	28,580	5,279,439
Detyrime ndaj institucioneve financiare	-	26,415,485	-	26,415,485
Detyrime ndaj palëve të treta	2,506,000	-	-	2,506,000
Detyrime të tjera	9,908,529	12,348,337	4,128	22,260,994
<b>Totali i detyrimeve</b>	<b>171,932,705</b>	<b>319,559,472</b>	<b>1,125,127</b>	<b>492,617,304</b>
<b>Pozicioni neto</b>	<b>415,310,089</b>	<b>15,905,251</b>	<b>45,325,223</b>	<b>476,540,563</b>



## 5. MENAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

## b) Analiza e riçimit të normës së interesit

Tabelat e mëposhtme paraqesin aktivet dhe detyrimet financiare të Shoqërisë të analizuar në bazë të periudhave të riçimit e përcaktuar si periudha më e hershme midis periudhës së mbetur deri në maturim sipas kontratës dhe periudhës së riçimit sipas kontratës. Tabelat janë një llogaritje e rrezikut të normës së interesit për grupin më 31 dhjetor 2013 dhe 31 dhjetor 2012 dhe nuk janë tregues për periudha të tjera gjatë vitit, por japin një të dhënë për ndjeshmërinë e të ardhurave të Shoqërisë ndaj lëvizjeve në normat e interesit. Të ardhurat ndikohen gjithashtu dhe nga monedha e aktiveve, detyrimeve dhe kapitalit. Shoqëria ka një pjesë të rëndësishme të aktiveve që mbartin interes të shprehura në monedhë të huaj.

2013	Norma efektive e interesit	Deri në 6 muaj	6-12 muaj	1-2 vite	2-5 vite	Më tepër se 5 vite	Shuma me norma fikse	Që nuk mbartin interes	Totali
<b>Aktive Financiare</b>									
Mjete monetare dhe ekuivalentë me to		-	-	-	-	-	-	8,214,561	8,214,561
Depozita me afat	3.07%	333,675,685	232,400,178	-	-	-	-	-	566,075,863
<b>Totali i aktiveve financiare</b>		<b>333,675,685</b>	<b>232,400,178</b>	-	-	-	-	<b>8,214,561</b>	<b>574,290,424</b>
<b>Detyrimet financiare</b>									
Detyrime ndaj insti.financiare	6.80%	7,282,428	6,626,074	-	-	-	-	-	13,908,502
<b>Totali i detyrimeve financiare</b>		<b>7,282,428</b>	<b>6,626,074</b>	-	-	-	-	-	<b>13,908,502</b>
2012	Norma efektive e interesit	Deri në 6 muaj	6-12 muaj	1-2 vite	2-5 vite	Më tepër se 5 vite	Shuma me norma fikse	Që nuk mbartin interes	Totali
<b>Aktive Financiare</b>									
Mjete monetare dhe ekuivalentë me to		-	-	-	-	-	-	12,735,772	12,735,772
Depozita me afat	6.09%	408,782,497	122,682,447	-	-	-	-	-	531,464,944
<b>Totali i aktiveve financiare</b>		<b>408,782,497</b>	<b>122,682,447</b>	-	-	-	-	<b>12,735,772</b>	<b>544,200,716</b>
<b>Detyrimet financiare</b>									
Detyrime ndaj insti.financiare	6.80%	16,478,481	9,937,004	-	-	-	-	-	26,415,485
<b>Totali i detyrimeve financiare</b>		<b>16,478,481</b>	<b>9,937,004</b>	-	-	-	-	-	<b>26,415,485</b>

**5. MENAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)****c) Rreziku i kredisë**

Rreziku i kredisë i referohet rrezikut që pala tjetër do të dështojë në përmbushjen e detyrimeve kontraktuale duke sjellë humbje financiare për Shoqërinë. Shoqëria është e ekspozuar ndaj rrezikut të kredisë në depozitat me afat dhe të arkëtueshmet nga sigurimi dhe risigurimi i palës tjetër. Menaxhimi beson se rreziku i kredisë i lidhur me depozitat me afat nuk është i rëndësishëm.

Shoqëria e menaxhon ekspozimin ndaj rrezikut të kredisë në baza të vazhdueshme duke monitoruar vazhdimisht të arkëtueshmet nga sigurimi dhe risigurimi.

Të arkëtueshmet nga sigurimi dhe risigurimi më 31 dhjetor 2013 sipas maturitetit janë si më poshtë:

	<b>31 dhjetor 2013</b>	<b>%</b>
Më pak se 1 muaj	18,351,580	5%
1 – 3 muaj	5,884,942	2%
3 muaj deri në 1 vit	57,902,420	15%
Më shumë se një vit	296,695,835	78%
<b>Totali</b>	<b>378,834,777</b>	<b>100%</b>

Të arkëtueshmet nga sigurimi dhe risigurimi më 31 dhjetor 2012 sipas maturitetit janë si më poshtë:

	<b>31 dhjetor 2012</b>	<b>%</b>
Më pak se 1 muaj	20,040,250	6%
1 – 3 muaj	9,313,300	3%
3 muaj deri në 1 vit	69,415,335	20%
Më shumë se një vit	253,210,438	72%
<b>Totali</b>	<b>351,979,323</b>	<b>100%</b>

**d) Rreziku i likuiditetit**

Rreziku i likuiditetit është rreziku që Shoqëria nuk do të mund të përballojë detyrimet që lidhen me detyrimet financiare kur ato lindin.

Shoqëria ka adoptuar një strukturë të përshtatshme për menaxhimin e rrezikut të likuiditetit për menaxhimin e kërkesave të likuiditetit të Shoqërisë. Shoqëria e menaxhon rrezikun e likuiditetit duke mbajtur mjete monetare bankare dhe rezerva për huatë duke monitoruar vazhdimisht flukset monetare të parashikuara dhe aktuale dhe duke përputhur maturitete e aktiveve dhe detyrimeve. Shoqëria është e ekspozuar ndaj rrezikut të likuiditetit që lind nga klientët si pasojë e kontratave të sigurimit.

Menaxhimi i likuiditetit siguron që Shoqëria ka fonde të mjaftueshme për të mbuluar dëmet nga sigurimi dhe detyrimet e maturuara.



## SiCRED sha

## Shënime të pasqyrave financiare te vecanta për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013

(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur është shprehur ndryshe)

## 5. MENAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

## d) Rreziku i likuiditetit (vazhdim)

Ekspozimi ndaj rrezikut të likuiditetit më 31 dhjetor 2013 është si më poshtë:

	Më pak se 1 muaj	1 - 3 muaj	3 muaj Deri në 1 vit	1 - 5 vjet	Më shumë se 5 vjet	Totali
<b>Aktivë financiarë</b>						
Mjete monetare dhe ekuivalentë me to	8,214,561	-	-	-	-	8,214,561
Depozita me afat	198,276,484	15,000,000	352,799,379	-	-	566,075,863
Aktivët e risiguruar	11,411,280	-	-	-	-	11,411,280
Të arkëtueshme nga sigurimi dhe risigurimi	18,351,580	5,884,942	57,902,420	109,928,332	186,767,503	378,834,777
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura	360,660	-	-	-	-	360,660
Parapagime të tatim fitimit	4,833,116	-	-	-	-	4,833,116
Aktive të tjera	6,762,573	1,356,365	2,281,691	-	-	10,400,629
<b>Totali i aktiveve</b>	<b>248,210,254</b>	<b>22,241,307</b>	<b>412,983,490</b>	<b>109,928,332</b>	<b>186,767,503</b>	<b>980,130,886</b>
<b>Detyrime financiare</b>						
Detyrime për humbjet dhe rregullimet për humbjet	-	892,653	10,283,220	-	-	11,175,873
Rezerva për primin e pafituar	416,523	383,672.00	14,089,643	52,403,630	44,884,304	112,177,772
Rezerva të tjera	-	-	914,384	81,363,668	-	82,278,052
Të ardhura të shtyra për periudhat e ardhshme	2,460,883	4,921,766	22,147,947	109,928,339	177,980,756	317,439,691
Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura	4,051,500	-	-	-	-	4,051,500
Detyrime për sigurimin dhe risigurimin	693,106	-	-	-	-	693,106
Detyrime për institucine financiare	-	-	7,282,428	6,626,074	-	13,908,502
Detyrime të tjera	22,061,769	-	-	-	-	22,061,769
	<b>29,683,781</b>	<b>6,198,091</b>	<b>54,717,622</b>	<b>250,321,711</b>	<b>222,865,060</b>	<b>563,786,265</b>
<b>Hendeku i maturitetit</b>	<b>218,526,473</b>	<b>16,043,216</b>	<b>358,265,868</b>	<b>(140,393,379)</b>	<b>(36,097,557)</b>	<b>416,344,621</b>
<b>Efkti i akumuluar</b>	<b>218,526,473</b>	<b>234,569,689</b>	<b>592,835,557</b>	<b>452,442,178</b>	<b>416,344,621</b>	<b>-</b>



(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur është shprehur ndryshe)

**5. MENAXHIMI I REZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)****d) Rreziku i likuiditetit (vazhdim)**

Ekspozimi ndaj rrezikut të likuiditetit më 31 dhjetor 2012 është si më poshtë:

	<b>Më pak se 1 muaj</b>	<b>1 - 3 muaj</b>	<b>3 muaj deri në 1 vit</b>	<b>1 - 5 vjet</b>	<b>Më shumë se 5 vjet</b>	<b>Totali</b>
<b>Aktivë financiarë</b>						
Mjete monetare dhe ekuivalentë	12,735,772	-	-	-	-	12,735,772
Depozita me afat	258,201,744	55,000,010	218,263,190	-	-	531,464,944
Aktivët e risiguruar	14,325,043	-	-	-	-	14,325,043
Të arkëtueshme nga sigurimi dhe risigurimi	20,040,250	9,313,300	69,415,335	112,012,533	141,197,905	351,979,323
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura	-	300,000	-	-	-	300,000
Parapagime të tatim fitimit	12,138,433	-	-	-	-	12,138,433
Aktive të tjera	-	4,541,597	1,109,452	800,206	-	6,451,255
<b>Totali i aktiveve</b>	<b>317,441,242</b>	<b>69,154,907</b>	<b>288,787,977</b>	<b>112,812,739</b>	<b>141,197,905</b>	<b>929,394,770</b>
<b>Detyrime financiare</b>						
Detyrime për humbjet dhe rregullimet për humbjet	-	2,952,163	2,529,371	-	-	5,481,534
Rezerva për primin e pafituar	415,377	416,475	39,288,225	15,882,146	41,205,673	97,207,896
Rezerva të tjera	-	-	-	65,377,116	-	65,377,116
Të ardhura të shtyra per periudhat e ardhshme	854,702	1,709,405	21,567,338	112,012,533	131,944,862	268,088,840
Detyrime ndaj palëve të treta	2,506,000	-	-	-	-	2,506,000
Detyrime për sigurimin dhe risigurimin	5,279,439	-	-	-	-	5,279,439
Detyrime ndaj institucioneve financiare	270,306	545,013	19,005,239	6,594,927	-	26,415,485
Detyrime të tjera	22,260,994	-	-	-	-	22,260,994
	<b>31,586,818</b>	<b>5,623,056</b>	<b>82,390,173</b>	<b>199,866,722</b>	<b>173,150,535</b>	<b>492,617,304</b>
<b>Hendeku i maturitetit</b>	<b>285,854,424</b>	<b>63,531,851</b>	<b>206,397,804</b>	<b>(87,053,983)</b>	<b>(31,952,630)</b>	<b>436,777,466</b>
<b>Efkti i akumuluar</b>	<b>285,854,424</b>	<b>349,386,275</b>	<b>555,784,079</b>	<b>468,730,096</b>	<b>436,777,466</b>	<b>-</b>

**5. MENAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR (vazhdim)****e) Interesi teknik**

Norma e interesit teknik është llogaritur për secilën nga monedhat: Lek 4.07%, Eur 1.83% dhe Usd 1.82%, duke u bazuar në normat mesatare të depozitave. Norma e interesit teknik është minimumi i kthimit të garantuar për çdo kontratë sigurimi për jetën. Ka një rrezik që të ardhurat nga investimet nuk do të mbulojnë minimumin e kthimeve të garantuara. Në 2013-ën të ardhurat neto të gjeneruara nga investimet (duke përfshirë edhe rezervën matematikore) mbulojnë minimumin e të ardhurave të garantuara, duke siguruar fitime shtesë mbi interesin teknik.

Analizat e parametrave aktuarialë të përdorura në llogaritjen e tarifave dhe rezervave për sigurimin e jetës tregojnë që supozimet e bëra janë të përshtatshme. Zhvillimi i favorshëm i rrezikut krahasuar me vlerat e pritshme garanton që rezervat janë matur në mënyrë të saktë.

**f) Rezervat dhe testi i mjaftueshmërisë për supozimet aktuariale**

Shoqëria llogarit dhe ngarkon rezervat e sigurimit për jetën (rezervat matematikore) për të paraqitur pagesat e ardhshme nën policat e sigurimit me afat të gjatë. Shumë faktorë ndikojnë llogaritjen e këtyre rezervave duke përfshirë vdekshmërinë, anulimet dhe interesin teknik. Rezerva për sigurimin e jetës është llogaritur në bazë të supozimeve aktuale për parametrat bazë.

Testi i mjaftueshmërisë së detyrimeve është i limituar në analizën e parametrave kryesorë të cilat kanë ndikimin më të madh në llogaritjen e rezervës.

“Vdekshmëria” është rreziku që mbulohet nga të gjithë produktet e sigurimit që Shoqëria ka. Të dhënat për rrezikun e “vdekshmërisë” për 2013 janë si më poshtë:

Numri i personave të dyshuar për rrezikun e vdekjes	47,289 persona
Mosha e personave të dyshuar për rrezikun e vdekjes	18 -70 vjec
Numri i pagesave për të siguruarit që kanë vdekur gjatë 2013	33 raste
Numri i vdekshmërisë i llogaritur në 1000 njerëz	0.35 deri në 33.06
Numri i vdekshmërisë në 1000 njerëz	0.69

Kështu që, rreziku i “vdekshmërisë” i paraqitur në këtë tabelë është brenda pritshmërisë.

**g) Rreziku i risigurimit**

Shoqëria cedon rrezikun e sigurimit që të limitojë ekspozimin e humbjeve nën marrëveshje të ndara për çdo lloj sigurimi. Këto marrëveshje risigurimi e shpërndajnë rrezikun dhe minimizojnë efektin e humbjes. Shuma e secilit rrezik të mbetur varet nga vlerësimi që Shoqëria i bën rreziqeve specifike, subjekt i disa rrethanave për limitet maksimale të bazuara në karakteristikat e mbulimit. Në termat e marrëveshjes së risigurimit, risiguresi bie dakort që të rimbursojë shumën e ceduar në rastin e dëmeve të paguara. Megjithatë, Shoqëria mbetet e detyruar ndaj policëmbajtësve të saj në lidhje me sigurimin e ceduar nëse risiguresi nuk përmbush detyrimet e tij.

Kur zgjedh risiguresin Shoqëria merr në konsideratë sigurinë e tij. Siguria e risiguresit vlerësohet nga informacionet publike të kategorizimeve dhe nga investigime të brëndshme. Risiguresi aktual ka një vlerësim A+/të Qëndrueshëm nga “Standard and Poor’s”.



**5. MENAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)****h) Analiza e sensitivitetit**

Faktorët kryesorë të cilët ndikojnë fitimin e Shoqërisë janë niveli i dëmeve dhe shpenzimet.

Situata më 31 dhjetor 2013	Fitimi/(Humbja)	Kapitali neto	Fondet e garancisë së detyrueshme
Aktual	4,375,240	515,462,592	370,778,787
Rritje në dëmet e ndodhura	(2,983,072)	512,479,520	370,000,000
Rritje në shpenzime (+10%)	(11,352,570)	501,126,950	370,000,000

Tabela më sipër paraqet një simulim, duke marrë në konsideratë ndryshime drastike për dëmet e ndodhura ose rritje në shpenzime dhe efekti i saj në kapitalin neto të Shoqërisë dhe aftësinë paguese në dispozicion.

Për qëllime të simulimit, modeli përdor një rritje të dëmeve të barabartë me dëmin më të madh të ndodhura gjatë dy viteve të fundit dhe një rritje të shpenzimeve administrative prej 10%.

**i) Menaxhimi i kapitalit**

Objektivat kryesorë të Shoqërisë kur menaxhojnë kapitalin janë që të jenë në përputhje me kërkesat nga entet rregullatore Shqiptare për tregun e sigurimit duke mbajtur kapital mbi limitin e kërkuar; duke siguruar mundësinë e vijimësisë së aktivitetit të Shoqërisë në mënyrë që ajo mund të vazhdojë të gjenerojë fitime për aksionerët dhe përfitime për përfituesit e tjerë. Enti rregullator i Shoqërisë Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare Shqiptare vendos dhe monitoron kërkesat për kapitalin në mënyrë që të mbajë në çdo kohë kapitalin e sigurimit për sigurimin e jetës dhe jo-jetës i cili të paktën është i barabartë me nivelin e detyrueshëm të aftësisë paguese për sipërmarrjen siguroese. Në përputhje me ligjin shqiptar për sigurimin kapitali rregullator përbëhet nga kapitali bazë dhe kapitali shtesë. Kapitali bazë përfshin:

- kapitalin e paguar;
- rezervën e sigurimit, e cila nuk i përket drejtpërsëdrejti kontratave efektive të sigurimit ose atyre të cilat kanë qënë efektive;
- rezerva statutore;
- fitimin e vitit aktual dhe të akumuluar;

Kapitali bazë nuk përfshin:

- kapitalin e papaguar;
- aktivet e patrupëzuara;

Kapitali bazë nuk përfshin kontributin në natyrë dhe nuk duhet të jetë më i vogël se fondi i garancisë së përcaktuar. Fondi i garancisë është 370 milion lek.

Kapitali shtesë përfshin:

- Kapitalin e paguar në bazë të aksioneve preferenciale;
- Borxhin e varur;
- Letra me vlerë të vazhdueshme

Shoqëria mund të investojë aksionet e saj në aktive të qëndrueshme dhe aktive financiare. Ekspozimi i Shoqërisë me një bankë të vetme nuk mund të kalojë 25% të kapitalit rregullator dhe 10% për institucionet jo-bankare.



## **6. PËRDORIMI I LLOGARITJEVE DHE GJYKIMIT**

Shoqëria bën llogaritje dhe supozime që influencojnë shumat e raportuara të aktiveve dhe detyrimeve gjatë një viti fiskal. Llogaritjet dhe gjykimet janë vlerësuar rregullisht dhe janë bazuar në informacionet e tregut dhe faktorë të tjerë, duke përfshirë pritshmëritë e ngjarjeve të ardhshme që besohet të jenë të arsyeshme nën rrethana të caktuara.

*(i) Llogaritja e detyrimit nga sigurimi*

Shiko shënimin 3.d.

*(ii) Përcaktimi i vlerës së drejtë*

Politika kontabël të Shoqërisë për matjen e vlerës së drejtë është diskutuar në politikën kontabël 3.e.(vi). Shoqëria e mat vlerën e drejtë duke përdorur hierarkinë e mëposhtme të vlerës së drejtë e cila reflekton rëndësinë e inputeve në bërjen e matjeve:

-Niveli 1: Çmimet e tregut të kuotuar (të pakorrigjuara) në një treg aktiv për instrumenta identik.

-Niveli 2: Metoda vlerësimi të bazuara në të dhënat të vëzhgueshme, ose në mënyrë të drejtpërdrejtë (për shembull çmimi) ose në mënyrë jo të drejtpërdrejtë (për shembull si rezultat i çmimit). Kjo kategori përfshin instrumenta të vlerësuar duke përdorur: çmimet e kuotuar në tregje aktive për instrumenta të njëjtë; çmimet e kuotuar për instrumenta identik ose të njëjtë në treg që konsiderohen më pak aktive; ose metoda vlerësimi ku të gjithë të dhënat hyrëse janë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose në mënyrë jo të drejtpërdrejtë të vëzhgueshme nga të dhënat e tregut.

-Niveli 3: Metoda vlerësimi duke përdorur të dhëna të rëndësishme të pavëzhgueshme. Kjo kategori përfshin të gjithë instrumentat ku metoda e vlerësimit merr parasysh faktorë bazuar në të dhëna jo të vëzhgueshme të cilat kanë një efekt të rëndësishëm në vlerësimin e instrumentit. Kjo kategori përfshin instrumenta të cilat janë vlerësuar në bazë të çmimeve të kuotuar për instrumenta të njëjtë ku korrigjime të pavëzhgueshme të konsiderueshme ose supozime janë të detyruara që të reflektojnë diferencat midis instrumentave.

Metodat e vlerësimit përfshijnë vlerën aktuale neto dhe modelet e skontuara të flukseve të parasë, krahasime me instrumenta të njëjtë për të cilat ekzistojnë çmime të vëzhgueshme në treg dhe të bazuara në ecurinë aktuale të "yield"-it të përshtatshme për pjesën e mbetur të maturitetit. Supozimet dhe faktorët e përdorur në metodat e vlerësimit përfshijnë norma interesi pa rrezik dhe të tregut, normat e kredidhënies dhe prime të tjera të përdorura në llogaritjen normave të skontuara, obligacionet dhe çmimi i kapitalit, kurset e këmbimit, çmimi i kapitalit dhe çmimi i indeksuar i kapitalit dhe luhatjet e pritshme dhe të lidhura me njëra tjetrën. Objektivi i metodave të vlerësimit është që të arrijë në përcaktimin e vlerës së drejtë e cila reflekton çmimet e instrumentave financiarë në datën e raportimit, që do të ishin përcaktuar nga pjesëmarrësit në treg duke vepruar në kushte normale tregu.

*(iii) Llogaritja e tatimit mbi të ardhurat*

Duke filluar që nga 1 janari 2008 Shoqëria ka filluar aplikimin e Standarteve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar. Aplikimi i SNRF jep bazën për regjistrimet kur një njësi ekonomike është subjekt i tatimit mbi të ardhurat. Megjithatë, në datën e përgatitjes të këtyre pasqyrave financiare të vecanta ka limite të amendimeve për tatimin aktual mbi të ardhurat dhe udhëzime për llogaritjen e tatimit mbi fitim. Menaxhimi beson që provigjionimi i tatimi mbi të ardhurat është i drejtë dhe duke pasur parasysh mossigurinë e ambientit të taksave në Shqipëri dhe legjislacionin ekzistues dhe cdo tatim i ardhshëm nuk do të ketë ndonjë efekt në pozicionin financiar të Shoqërisë rezultatet e veprimtarisë ose flukset e ardhshme të parasë.



## 7. PARAQITJA E VLERËS SË DREJTË

Llogaritjet e vlerës së drejtë janë bazuar në instrumentat financiarë ekzistues në bilanc pa u përpjekur që të llogaritet vlera e ardhshme e biznesit dhe vlera e aktiveve dhe detyrimeve të cilat nuk konsiderohen instrumenta financiarë.

*Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre dhe Depozita me afat me bankat* - të cilat përfshijnë paratë në banka dhe depozitat me afat, përfshijnë vendosjet ndërbankare dhe zëra në proces mbledhjeje. Duke qënë se depozitat janë afatshkurtra dhe me norma të luhatshme, vlera e tyre e drejtë konsiderohet të jetë e afërt me vlerën e tyre kontabël

*Detyrime nga llogaritë bankare* - Detyrime nga llogaritë bankare, të cilët përbëhen nga mjete monetare dhe depozita me afat, përfshijnë gjendje midis bankave dhe llogari që pritet të mblidhen. Depozitat janë me afat të shkurtër dhe norma qarkulluese vlera e tyre reale konsiderohet të jetë e përafërt me vlerën e mbartur.

	Të mbajtura deri në maturim	Kreditë dhe të arkëtueshmet	Kosto të tjera të amortizimit	Totali i vlerës së mbartur	Vlera e drejtë
<b>31 dhjetor 2013</b>					
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	-	8,214,561	-	8,214,561	8,214,561
Depozita me afat	-	566,075,863	-	566,075,863	566,075,863
<b>31 dhjetor 2012</b>					
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	-	12,735,772	-	12,735,772	12,735,772
Depozita me afat	-	531,464,944	-	531,464,944	531,464,944

## 8. MJETE MONETARE NË ARKË DHE BANKË

Mjetet monetare në arkë dhe bankë janë si më poshtë:

	31 dhjetor 2013	31 dhjetor 2012
Mjete monetare në arkë	65,119	444,780
Mjete monetare në bankë		
Në monedhë të huaj	2,916,064	1,276,668
Në Lek	5,233,378	10,620,215
Nëntotali i mjeteve monetare në bankë	8,149,442	11,896,883
<b>Mjete monetare në arkë dhe bankë</b>	<b>8,214,561</b>	<b>12,341,663</b>
Balancat e kushtëzuara	-	394,109
<b>Totali</b>	<b>8,214,561</b>	<b>12,735,772</b>

Mjetet monetare në bankë në monedhë të huaj janë si më poshtë:

	31 dhjetor 2013	31 dhjetor 2012
EUR	2,873,041	1,171,535
US Dollar	43,023	105,133
<b>Totali</b>	<b>2,916,064</b>	<b>1,276,668</b>

**9. DEPOZITAT ME AFAT**

Depozitat me afat janë të përbëra si më poshtë:

	<b>2013</b>	<b>2012</b>
Depozita garancie	370,778,787	397,273,107
Depozita me afat	97,103,000	51,979,500
Llogari kursimi	81,363,765	64,800,753
Interesi përlllogaritur	16,830,311	17,411,584
<b>Totali</b>	<b>566,075,863</b>	<b>531,464,944</b>

Depozitat e garancisë paraqesin depozita me afat me maturitet 1 vjeçar në Lek, Euro dhe Dollarë të vendosura në bankat lokale të cilat janë të kushtëzuara dhe mbahen si garanci në përputhje me kërkesat nga Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare. Depozitat me maturitet më të vogël se një vit sipas bankave janë si më poshtë:

	<b>2013</b>	<b>2012</b>
Banka Credins	106,363,765	129,800,753
Societe Generale Albania	120,000,000	110,000,000
Tirana Bank	109,562,787	125,749,607
Crédit Agricole Bank	59,020,000	48,959,000
Banka Kombëtare e Greqisë (Dega Tiranë)	94,206,000	84,544,000
Union Bank	30,093,000	15,000,000
Intesa Sanpaolo	10,000,000	-
BKT	10,000,000	-
Raiffeisen Bank	10,000,000	-
Interesi përlllogaritur	16,830,311	17,411,584
<b>Totali</b>	<b>566,075,863</b>	<b>531,464,944</b>

**10. INVESTIME NE FILIALE**

Investimi përfaqëson kontributin në kapital në filialet e Shoqërisë më 31 Dhjetor 2013 dhe 31 Dhjetor 2012.

	<b>2013</b>	<b>2012</b>
SiCRED Pensions	52,181,670	36,130,170
SiCRED Assistance	100,000	100,000
<b>Totali</b>	<b>52,281,670</b>	<b>36,230,170</b>

Bazuar ne vendimin më 29 Mars 2013, Asambleja e Aksionarëve të “Shoqëria Administruese e Fondit të Pensionit SiCRED sh.a” vendosi rritjen e kapitalit në vlerën prej 21,402,000 Lek e përbërë nga 16,051,500 Lek nga shoqëria dhe 5,350,500 Lek nga KURUM International. Deri më 31 Dhjetor 2013 është paguar nga shoqëria shuma në vlerën 12 Milion Lek ndërkohë që shuma 4,051,500 Lek mbeti e papaguar (shih shënimin 28) dhe është paguar plotësisht në datën e lëshimit të këtyre pasqyrave financiare të vecanta.



**11. AKTIVET E RISIGURUARA**

Shoqëria cedon primet e sigurimit dhe rrezikun në aktivitetin normal të biznesit për sigurimin e jetës në mënyrë që të limitojë potencialin e humbjeve që lindin nga ekspozime më të gjata dhe më të ashpra të dëmeve. Këto risigurime përfshijnë bazat e marrëveshjeve, tejkalimin e humbjeve dhe pjesë të aksioneve. Shoqëria cedon sigurim ndaj shoqërive të tjera dhe këto kontrata risigurimi nuk e përjashtojnë Shoqërinë nga detyrimi ndaj policëmbajtësve. Kështu që, ekziston një ekspozim kredie në lidhje me risigurimin e ceduar deri në masën që një risigruues nuk është në gjendje që të përmbushë detyrimet e tij sipas marrëveshjes risigruuese. Shoqëria nuk mban kolateral sipas marrëveshjes risigruuese. Më 31 dhjetor 2013 shuma prej 11,411,280 Lek (2012: 14,325,043 Lek) paraqet pjesën e risigruuesit për detyrimet për primin e pafitur. Lëvizjet e aktiveve të risigurimit për 31 dhjetorin 2013 janë si më poshtë:

	<b>31 dhjetor 2013</b>	<b>Ndryshimi për vitin</b>	<b>31 dhjetor 2012</b>	<b>Ndryshimi për vitin</b>	<b>31 dhjetor 2011</b>
Në fillim të vitit	14,325,043	1,146,642	13,178,401	(1,057,731)	14,236,132
Ndryshimi për vitin	(2,913,763)	(4,060,405)	1,146,642	2,204,373	(1,057,731)
<b>Totali</b>	<b>11,411,280</b>	<b>(2,913,763)</b>	<b>14,325,043</b>	<b>1,146,642</b>	<b>13,178,401</b>

## SiCRED sh.a

## Shënime të pasqyrave financiare të vecanta për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013

(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur është shprehur ndryshe)

## 12. PAJISJE

	Pajisje zyre	Orendi dhe pajisje	Makina	Makina me qera financiare	Prona (Kioska)	Vepra arti	Përmirësimi i ambienteve të marra me qira	Ndertime në progres	Totali
<b>Kosto</b>									
<b>Më 1 janar 2012</b>	<b>12,114,410</b>	<b>11,737,382</b>	<b>5,797,048</b>	<b>2,075,000</b>	<b>595,000</b>	<b>33,333</b>	<b>14,137,219</b>	-	<b>46,489,392</b>
Shtesa	3,736,102	1,703,248	-	11,735,586	-	-	2,016,903	-	19,191,839
Nxjerrje jashtë përdorimi	(152,640)	(419,680)	(4,444,048)	-	-	-	-	-	(5,016,368)
Riklasifikime	-	-	2,075,000	(2,075,000)	-	-	-	-	-
<b>Më 31 dhjetor 2012</b>	<b>15,697,872</b>	<b>13,020,950</b>	<b>3,428,000</b>	<b>11,735,586</b>	<b>595,000</b>	<b>33,333</b>	<b>16,154,122</b>	-	<b>60,664,863</b>
Shtesa	1,158,547	1,528,364	-	-	-	-	2,405,271	7,637,070	12,729,252
Nxjerrje jashtë përdorimi	(21,500)	(1,873,092)	-	-	-	-	-	-	(1,894,592)
<b>Më 31 dhjetor 2013</b>	<b>16,834,919</b>	<b>12,676,222</b>	<b>3,428,000</b>	<b>11,735,586</b>	<b>595,000</b>	<b>33,333</b>	<b>18,559,393</b>	<b>7,637,070</b>	<b>71,499,523</b>
<b>Amortizim i akumuluar</b>									
<b>Më 1 janar 2012</b>	<b>6,488,841</b>	<b>6,710,427</b>	<b>3,477,607</b>	<b>968,332</b>	<b>85,257</b>	-	<b>5,981,928</b>	-	<b>23,712,392</b>
Shpenzimi i vitit	1,862,892	1,102,130	630,615	464,524	25,487	-	1,844,812	-	5,930,460
Nxjerrje jashtë përdorimi	(136,934)	(309,009)	(2,110,502)	(968,333)	-	-	-	-	(3,524,778)
<b>Më 31 dhjetor 2012</b>	<b>8,214,799</b>	<b>7,503,548</b>	<b>1,997,720</b>	<b>464,523</b>	<b>110,744</b>	-	<b>7,826,740</b>	-	<b>26,118,074</b>
Shpenzimi i vitit	1,996,227	1,279,757	286,057	2,254,212	24,213	-	2,090,991	-	7,931,457
Nxjerrje jashtë përdorimi	(5,375)	(1,436,829)	-	-	-	-	-	-	(1,442,204)
<b>Më 31 dhjetor 2013</b>	<b>10,205,651</b>	<b>7,346,476</b>	<b>2,283,777</b>	<b>2,718,735</b>	<b>134,957</b>	-	<b>9,917,731</b>	-	<b>32,607,327</b>
<b>Vlera kontabël neto</b>									
<b>Më 1 janar 2012</b>	<b>5,625,569</b>	<b>5,026,955</b>	<b>2,319,441</b>	<b>1,106,668</b>	<b>509,743</b>	<b>33,333</b>	<b>8,155,291</b>	-	<b>22,777,000</b>
<b>Më 31 dhjetor 2012</b>	<b>7,483,073</b>	<b>5,517,402</b>	<b>1,430,280</b>	<b>11,271,063</b>	<b>484,256</b>	<b>33,333</b>	<b>8,327,382</b>	-	<b>34,546,789</b>
<b>Më 31 dhjetor 2013</b>	<b>6,629,268</b>	<b>5,329,746</b>	<b>1,144,223</b>	<b>9,016,851</b>	<b>460,043</b>	<b>33,333</b>	<b>8,641,662</b>	<b>7,637,070</b>	<b>38,892,196</b>



(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur është shprehur ndryshe)

**13. TË ARKËTUESHMET NGA SIGURIMI DHE RISIGURIMI****13.1 Të arkëtueshmet nga sigurimi dhe risigurimi, neto**

	<b>31 dhjetor 2013</b>	<b>31 dhjetor 2012</b>
Të arkëtueshme nga sigurimi	378,394,411	352,010,363
Të arkëtueshme nga risigurimi	440,366	-
Zhvlerësimi i të arkëtueshmeve nga sigurimi	-	(31,040)
<b>Totali</b>	<b><u>378,834,777</u></b>	<b><u>351,979,323</u></b>

Të arkëtueshmet nga sigurimi kryesisht lidhen me policat e sigurimit lëshuar për punonjësit e ARMO Sh.a , kliente te Bankes Societe Generale dhe Bankes Credins. Më 31 dhjetor 2013 dhe 2012 Shoqëria ka njohur si të arkëtueshme primin e shkruar kontraktual dhe ka njohur si të ardhura të shtyra shumën 317,439,690 Lek (2012: 268,088,840 Lek), atë pjesë të primit të shkruar të përbërë nga shuma për tu paguar në periudhat raportuese financiare të mëpasshme.

**13.2 Detyrimet për sigurimin dhe risigurimin**

	<b>31 dhjetor 2013</b>	<b>31 dhjetor 2012</b>
Detyrimet për sigurimin	693,106	831,384
Detyrimet për risigurimin	-	4,448,055
<b>Totali</b>	<b><u>693,106</u></b>	<b><u>5,279,439</u></b>

**14. AKTIVE TË TJERA**

	<b>31 dhjetor 2013</b>	<b>31 dhjetor 2012</b>
Shpenzime të parapaguara	951,397	-
Inventari i policave	2,148,071	2,560,634
Paradhënie punonjësve	1,020,278	1,606,469
Të tjerë	6,280,883	2,284,152
<b>Totali</b>	<b><u>10,400,629</u></b>	<b><u>6,451,255</u></b>

**15. DETYRIMET PËR HUMBJET DHE SHPENZIMI I RREGULLIMIT TË HUMBJES**

Lëvizja e detyrimeve për humbjet dhe shpenzimin e rregullimit të humbjes është si më poshtë:

	<b>31 dhjetor 2013</b>	<b>31 dhjetor 2012</b>
<i>Më 1 janar</i>		
Detyrimet bruto të sigurimit për humbjet dhe shpenzimin e rregullimit të humbjes	<b>5,481,534</b>	<b>6,084,629</b>
Risigurimi i rikuperueshëm	-	-
<b>Detyrimet neto të sigurimit për humbjet dhe shpenzimin e rregullimit të humbjes</b>	<b>5,481,534</b>	<b>6,084,629</b>
Humbjet dhe shpenzimi i rregullimit të humbjes të ndodhura	27,974,118	22,947,540
Humbjet dhe shpenzimi i rregullimit të humbjes të paguara	(22,279,779)	(23,550,635)
<b>Detyrimet neto të sigurimit për humbjet dhe shpenzimin e rregullimit të humbjes më 31 dhjetor</b>	<b>11,175,873</b>	<b>5,481,534</b>
Risigurimi i rikuperueshëm	-	-
<b>Detyrimet bruto të sigurimit për humbjet dhe shpenzimin e rregullimit të humbjes</b>	<b><u>11,175,873</u></b>	<b><u>5,481,534</u></b>



(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur është shprehur ndryshe)

**15. DETYRIMET PËR HUMBJET DHE SHPENZIMI I RREGULLIMT TË HUMBJES (VAZHDIM)**

Vonesa të konsiderueshme ndodhin në njoftimin e dëmeve dhe një masë e konsiderueshme e përvojës dhe gjykimit përfshihet në vlerësimin e detyrimeve të papaguara të sigurimit, kostot përfundimtare të të cilave nuk mund të vlerësohen me siguri në datën e raportimit. Detyrimet e sigurimit për humbjet dhe shpenzimet për rregullimet nga humbjet përcaktohen mbi bazën e informacionit në dispozicion; gjithsesi, është e natyrshme në natyrën e biznesit që detyrimet përfundimtare mund të variojnë si rezultat i zhvillimeve të mëvonshme. Më 31 dhjetor 2013 Grup-i ka 65 dëme të pazgjidhura (2012: 58) shumica e të cilave kanë të bëjnë me Jeta dhe Shëndeti në udhëtim, për të cilën duhet më shumë kohë për investigim.

**16. REZERVA PËR PRIMET E PAFITUARA**

	<b>2013</b>	<b>Ndryshimi për periudhën</b>	<b>2012</b>	<b>Ndryshimi për periudhën</b>	<b>2011</b>
Jeta e debitorit	74,766,472	(219,745)	74,546,727	(27,198,426)	47,348,301
Jeta në grup dhe aksidentet	2,532,226	(1,635,857)	896,369	7,757,918	8,654,287
Sigurimi për jetën dhe shëndetin në udhëtim	2,048,883	(1,062,959)	985,924	881,990	1,867,914
Sigurimi për jetën e nxënësve dhe studentëve	3,361,178	(749,483)	2,611,695	(2,521,502)	90,193
Jeta e kombinuar	-	-	-	-	-
Studentët jashtë vendit	22,991	9,533	32,524	(3,627)	28,897
Sportistë	73	(73)	-	-	-
Cash Plan	29,431,929	(11,297,272)	18,134,657	(1,387,716)	16,746,941
Vizitorë	14,020	(14,020)	-	-	-
<b>Totali</b>	<b><u>112,177,772</u></b>	<b><u>(14,969,876)</u></b>	<b><u>97,207,896</u></b>	<b><u>(22,471,363)</u></b>	<b><u>74,736,533</u></b>

**17. REZERVA TË TJERA**

Rezervat e tjera më 31 dhjetor 2013 në shumën 82,278,052 Lek (2012: 65,377,116 Lek) paraqesin rezervën për sigurimin e jetës të krijuar për produktin e Jetës me Kursim për të cilin Grupi kontabilizon të gjithë shumën e fondit të akumuluar deri në datën e raportimit (shiko shënimin 3.d).

**18. DETYRIME NDAJ INSTITUCIONEVE FINANCIARE**

Më 22 tetor 2012, Shoqëria SiCRED Sh.a. nënshkroi një marrëveshje kredie dhe mori një overdraft prej 130,000 Eur nga Banka Credins. Ky overdraft mbart interes vjetor Libor 6M+6.7%. Shuma e papaguar më 31 dhjetor 2013 është 7,282,428 Lek (2012: 16,478,481 Lek). Gjatë 2012, Shoqëria gjithashtu nënshkroi dy marrëveshje qeraje financiare me "SOGLEASE ALBANIA". Këto qera financiare mbartin interes vjetor 6.5% për vitin e pare dhe Libor Euro 12 months + 4.5% (minimum 7%) duke filluar që nga viti i dytë. Shuma e papaguar më 31 dhjetor 2013 është 6,626,074 Lek (2012: 9,937,004 Lek).

**19. DETYRIME TË TJERA**

	<b>31 Dhjetor 2013</b>	<b>31 Dhjetor 2012</b>
Furnitorët	11,655,930	11,268,630
Detyrime për blerjen e Shoqërise së Fondit të Pensioneve	-	6,979,500
Kontributet shoqërore dhe tatimi	1,674,831	1,593,073
Taksa të tjera të ndryshme nga tatimi	1,197,812	119,468
Kreditorë të tjerë	7,533,196	2,300,323
<b>Totali</b>	<b><u>22,061,769</u></b>	<b><u>22,260,994</u></b>



(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur është shprehur ndryshe)

**20. KAPITALI AKSIONER****20.1 Kapitali i paguar**

Më 29 Qershor 2012, kapitali i rregjistruar u rrit nëpërmjet fitimit të akumuluar të transferuar tek kapitali i nënshkruar, jo i rregjistruar në atë kohë në shumën 67,800,000 Lek dhe pas rregjistrimit në QKR u transferua në kapital aksioner duke e rritur në 473,300,000 Lek (2012: 405,500,000 Lek).

Me Vendimin Nr 06. Date 07.06.2013 të Asamblese së Aksionereve u vendos shitja e aksioneve që zotëronte aksioneri Z.Gjergj Krali në favor të Z. Kristino Kromidha.

Struktura e aksionerëve të Shoqërisë është si më poshtë:

	<b>31 dhjetor 2013</b>	<b>31 dhjetor 2012</b>
Aleksander Pilo	46.30%	46.30%
Renis Tershana	30.10%	30.10%
Gjergj Krajli	0%	4.13%
Kristino Kromidha	4.13%	0%
Artan Santo	4.74%	4.74%
Monika Milo	4.74%	4.74%
Maltin Kolkuti	4.74%	4.74%
Petraa Shomo	2.10%	2.10%
Arben Taipi	2.10%	2.10%
Artan Xhori	1.05%	1.05%
<b>Totali</b>	<b>100.00%</b>	<b>100.00%</b>

Fondi i garancisë më 31 dhjetor 2013 and 2012 është si më poshtë:

	<b>31 dhjetor 2013</b>	<b>31 dhjetor 2012</b>
Depozita me afat (shënimi 9)	370,778,787	397,273,107
<b>Totali</b>	<b>370,778,787</b>	<b>397,273,107</b>

**20.2 Kapitali i nënshkruar i parregjistruar**

Më 7 Qershor 2013, Asambleja e Aksionerëve me Vendim Nr. 10 rriti kapitalin e rregjistruar nëpërmjet fitimit të akumuluar për vitin 2012, duke transferuar tek kapitali i nënshkruar, i parregjistruar shumën prej 3,700,000 Lek. Ky kapital i nënshkruar, por i parregjistruar duhet të rregjistrohet në Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit. Gjithashtu shiko shënimin 20.1. Balanca e kapitalit të nënshkruar të parregjistruar në 31 Dhjetor 2012 ishte 67,800,000 Lek.

**20.3 Rezervat Ligjore**

Rezervat ligjore janë krijuar në përputhje me ligjin “Për Shoqëritë Tregtare” i cili kërkon krijimin e rezervës duke mbajtur 5% të fitimit pas tatimit nga viti i mëparshëm. Në vijim të hyrjes në fuqi të Ligjit për Sigurimin kjo rezervë nuk është më e detyrueshme. Në datën e lëshimit të këtyre pasqyrave financiare të vecanta nuk ka ndonjë vendim specifik nga Asambleja e Përgjithshme e Aksionerëve për të ardhmen e kësaj rezerve.

**20.4 Rezerva e rrezikut të sigurimit**

Rezerva e rrezikut të sigurimit është krijuar në bazë të nenit 93 të Ligjit të Sigurimit në shumën e një të tretës të fitimit të vitit paraardhës nëse ai nuk është përdorur për të mbuluar humbjet e trashëguara nga vitet e mëparshme. Kjo rezervë nuk rritet më shumë se 30% e shumës mesatare të primeve të mbledhura gjatë dy viteve të fundit. Kjo rezervë është krijuar që të garantojë aftësinë paguese dhe fondet e garancisë.

*(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur është shprehur ndryshe)***20. KAPITALI AKSIONER (VAZHDIM)****20.5 Dividentët e paguar**

Vendimi për shpërndarjen e dividentëve i takon aksionerëve dhe shpërndahen në përputhje me ligjin “Për Shoqëritë Tregtare” nr 9901, datë “14 Prill 2008” (ndryshuar). Më 06 Qershor 2013 me Vendimin Nr. 10 dhe Nr.11. Asambleja e aksionarëve aprovuan pagesën e dividentit dhe shpërndarjen e fitimit për vitin fiskal 2012 si më poshtë:

Fitimi neto për 2012	4,507,664
Transferimi në rezervën e sigurisë	807,664
Rritja në kapitalin aksioner	3,700,000
Dividend i paguar 2013	0

**21. PRIMET E SHKRUARA BRUTO**

	Viti që mbyllet më 31 dhjetor 2013	Viti që mbyllet më 31 dhjetor 2012
Jeta e debitorit	116,135,910	127,025,759
Sigurimi për jetën dhe shendetin (Cash plan)	42,071,798	23,756,435
Sigurimi për jetën dhe shendetin në udhëtim	18,537,121	18,226,865
Sigurimi për jetën me kursim (Llogari kursimi)	19,276,456	16,921,838
Jeta e studentëve dhe nxënësve	12,559,200	14,071,900
Jeta në grup dhe aksidentet	9,623,471	4,959,910
Sigurimi për jetën me kursim	2,424,052	2,208,611
Studentët jashtë vendit	87,416	92,675
Vizitor	44,687	-
Sportistët	5,500	-
<b>Totali</b>	<b>220,765,611</b>	<b>207,263,993</b>

**22. PRIMET E CEDUARA RISIGURUESIT**

Primet e ceduara risiguruesit janë në shumën 14,857,305 Lek (2012: 16,768,337 Lek) të cilat lidhen me produktet e sigurimit të jetës së debitorit me risiguruesin Scor Global Life.

**23. TË ARDHURAT NGA INVESTIMET**

	Viti që mbyllet më 31 dhjetor 2013	Viti që mbyllet më 31 dhjetor 2012
Të ardhurat nga depozitat me afat	28,871,513	28,959,146
Të ardhurat nga llogaritë rrjedhëse	977,984	1,535
<b>Totali</b>	<b>29,849,497</b>	<b>28,960,681</b>

**24. KOSTOT E MARRJES NË SIGURIM**

	Viti që mbyllet më 31 dhjetor 2013	Viti që mbyllet më 31 dhjetor 2012
Komisione	24,499,434	24,335,228
Shpenzime publiciteti	27,803,931	24,129,991
Shpenzime mjeksore	6,957,600	2,365,165
Blerje e policave	1,115,023	1,022,712
<b>Totali</b>	<b>60,375,988</b>	<b>51,853,096</b>



**25. SHPENZIME ADMINISTRATIVE**

	Viti që mbyllet më 31 dhjetor 2013	Viti që mbyllet më 31 dhjetor 2012
Shpenzime personeli	53,793,416	55,536,904
Shpenzime qeraje	26,111,637	13,303,780
Shërbime të jashtme	5,716,503	5,173,071
Tarifa, tatime dhe gjoba	4,735,517	4,949,921
Ujë, energji dhe komunikim	4,506,873	4,095,280
Të tjera	18,661,755	23,122,096
<b>Total</b>	<b>113,525,701</b>	<b>106,181,052</b>

**26. SHPENZIME PËR TATIMIN**

Llogaritja e tatimit vjetor është si më poshtë:

		2013		2012
Fitimi para tatimit		5,321,060		5,578,243
<b>Fitimi i taksueshëm për vitin</b>		<b>5,321,060</b>		<b>5,578,243</b>
Shpenzimi tatimit për vitin aktual 10 % (2012: 10%)	10%	532,106	10%	557,824
Shpenzimet e pazbritshme për qëllime tatimore	7.78%	413,714	9.2%	512,755
<b>Shpenzimi tatimit</b>	<b>17.78%</b>	<b>945,820</b>	<b>19.2%</b>	<b>1,070,579</b>

Në përputhje me rregulloret tatimore Shqiptare norma e aplikueshme për tatimin 2013 është 10% (2012: 10%). Deklarimet tatimore plotësohen çdo vit, por fitimet ose humbjet e deklaruara për qëllim tatimi mbesin të provigjionuara deri kur autoritetet tatimore vlerësojnë kthimet dhe japin një vlerësim përfundimtar. Ligjet tatimore shqiptare janë subjekt i interpretimeve nga autoritete tatimore. Shpenzimet e pazbritshme për qëllim tatimi paraqesin shpenzime të cilat nuk janë të mbështetura me dokumentacion të përshtatshëm ose shpenzime të cilat nuk konsiderohen të klasifikueshme për qëllime fiskale.

Në bazë të ligjit lokal për kontabilitetin, duke filluar që nga 1 janari 2008 Shoqëritë e Sigurimit duhet të raportojnë sipas SNRF. Gjithashtu, Ligji Nr. 10364 më datë 16.12.2010 jep disa amendime (efektive më 24 janar 2011). Në bazë të këtyre amendimeve, detyrimet e sigurimit që ngarkohen nga shoqëritë e sigurimit në përputhje me SNRF duhet të konsiderohen shpenzime të zbritshme.

(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur është shprehur ndryshe)

**27. ANGAZHIME DHE DETYRIME****Ligjore**

Në aktivitetin normal të biznesit Shoqërisë i raportohen çështje ligjore të cilat nuk janë të lidhura me sigurimin; menaxhimi i Shoqërisë është i opinionit që nuk do të ketë humbje materiale të cilat do të lindin në lidhje me ndonjë nga këto çështje deri më 31 dhjetor 2013.

**Angazhimet për qeranë**

Shoqëria ka hyrë në angazhime qeraje operative për degë, zyrën qendrore dhe dy automjete. Pagesat minimale për fund vitet 31 dhjetor 2013 dhe 2012 janë si më poshtë:

	31 dhjetor 2013	31 dhjetor 2012
Jo më shumë se 1 vit	20,320,332	15,490,005
Më shumë se 1 vit por më pak se 5 vjet	69,874,338	37,787,829
Më shumë se 5 vjet	61,457,493	7,575,388
<b>Totali</b>	<b>151,652,163</b>	<b>60,853,222</b>

**28. TRANSAKSIONE ME PALËT E LIDHURA**

Palët konsiderohen të jenë të lidhura nëse një palë ka mundësinë që të kontrollojë ose që të ketë influencë të rëndësishme mbi palën tjetër në marrjen e vendimeve financiare ose operacionale, ose palët janë nën kontroll të përbashkët me Shoqërinë. Shoqëria ka një marrëdhënie si palë e lidhur me aksionerët e saj dhe me shoqëritë që janë nën kontrollin e saj.

- Shoqëria Administruese e Fondit të Pensionit SiCRED sh.a” (“SiCRED Pension”)- Filial
- SiCRED Assistance- Filial

Një numër transaksionesh janë kryer me palët e lidhura në aktivitetin normal të biznesit. Këto transaksione janë kryer me terma tregtare dhe në kushte tregu. Volumi i këtyre transaksioneve dhe balancat në fund të periudhave respektive janë si më poshtë:

	2013	2012
<b>Aktivet e sigurimit</b>		
Të arkëtueshme nga Sicred Assistance	360,660	300,000
<b>Detyrimet e sigurimit</b>		
Të pagueshme ndaj Fondit të Pensionit	4,051,500	2,506,000
<b>Primet e shkruara bruto</b>		
Sigurimi i Jetës	40,467	518,212
<b>Shpenzimet e sigurimit</b>		
Dëme të paguara	104,807	13,510
<b>Shpërndarja e dividendëve</b>		
Dividentët e paguar	-	3,900,000
<b>Të ardhura të tjera</b>		
Shërbime ndaj palëve të lidhura	1,440,000	-
<b>Shpenzimet administrative</b>		
Shërbime nga Sicred Assistance	180,000	-
Shpenzime personeli	288,000	246,000

Kompensimi total për drejtuesit kryesorë të Shoqërisë, të përfshira në shpenzimet administrative për fundin e vitit 31 dhjetor 2013 është 7,153 mijë Lek (2012: 8,500 mijë Lek).

**29. NGJARJET PAS DATËS SË BILANCIT**

Menaxhimi i Shoqërisë nuk është në dijeni të ndonjë ngjarje pas datës së raportimit që do të kërkonte rregullime ose sqarime shtesë në pasqyrat financiare të vecanta.



Skedulet Suplementare

**SiCRED sh.a.**

**Skedule suplementare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013**

*(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur është shprehur ndryshe)*

**1. AKTIVET NË MBULIMIN E REZERVËS TEKNIKE**

Në përputhje me Vendimin e Qeverisë nr. 96 datë 03 Gusht 2008, ndryshuar me vendimin nr. 5 datë 7 Janar 2009; shoqëritë e sigurimit nuk mund të investojnë më shumë në aktive dhe në rezerva teknike dhe matematike se përqindjet si më poshtë:

			<b>31 dhjetor 2013</b>
<b>Provizjone teknike dhe matematike bruto</b>			<b>205,631,697</b>
	<b>Limiti i investimeve si përqindje e rezerves bruto</b>	<b>Shuma e litimit të investuar sipas rregullores</b>	<b>Aktivet në mbulim të detyrimeve të sigurimit</b>
Mobilje dhe pajisje	5%	10,281,585	10,281,585
Aksione dhe investime në tregun e parasë vetëm në një palë	5%	10,281,585	-
Llogari të arkëtueshme nga sigurimi dhe risigurimi, neto	20%	41,126,339	22,618,431
Aktivet e risigurimit	No limit	No limit	11,411,280
Hua të pasiguruara	5%	10,281,585	-
Mjete monetare në arkë	3%	6,168,951	6,168,951
Letra me vlerë të tregëtuar në tregje të parregulluara	40%	82,252,679	-
Hua të hipotekuara	15%	30,844,755	-
Depozita me afat	No limit	No limit	166,045,552
Interesi i akumuluar	5%	10,281,585	10,281,585
			<b>226,807,384</b>



**SiCRED sh.a.**

**Skedule suplementare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013**

*(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur është shprehur ndryshe)*

**2. MARXHI I AFTËSISË PAGUESE**

Marxhi i aftësisë paguese duke përdorur metodën e kapitalit për 31 dhjetor 2013, është e përbërë si më poshtë:

***Niveli aktual i aftësisë paguese:***

Kapitali i paguar (shënimin 20)	477,000,000
Rezervat e sigurimit	34,087,352
Rezervat e rivlerësimit	-
Fitimi i mbartur	4,375,241
Investime në filiale	(52,281,670)
Llogari të arkëtueshme nga sigurimi dhe risigurimi, neto	(7,615,695)
Inventarët	(3,660,391)
Depozita të bllokuara për overdraft të marra	(13,200,000)
Përmirësime në ambjentet e marra me qera	(16,278,731)
	<hr/>
<b>Marxhi i i nivelit aktual të aftësisë paguese</b>	<b>422,426,105</b>